



• ASSEMBLY SUPPORT INITIATIVE
NEWSLETTER

Dhjetor 2007, Nr.30

Qeverisja efektive e mjedisit kërkon mbikqyrje të fuqishme parlamentare

Editorial



Ky edicion i tridhjetë i buletinit ASI është botim tematik mbi çështjen e mbikëqyrjes parlamentare të politikave mjedisore. Siç mund të mbahet mend, Kuvendi i Kosovës së bashku me Misionin e OSBE-së në Kosovë ka organizuar në Prishtinë konferencën rajonale parlamentare mbi çështjet mjedisore, nga 18 deri më 20 tetor, 2007. Prandaj, ky edicion i buletinit ASI përmban disa komente të prezantuar nga parlamentarët e Kosovës dhe nga Evropa Jug-Lindore, të cilët qenë të pranishëm në konferencë.

Nëse i vështrojmë punimet e saj, duket qartë se konferenca rajonale parlamentare mbi mjedisin ka shërbyer si platformë unike e politikave për të debatuar dhe parashtruar ide dhe koncepte të politikave. Në mesin e konkluzioneve që janë theksuar edhe në këtë botim, është nevoja që të vihet më shumë theks në zbatimin e ligjeve dhe të politikave që kanë të bëjnë me mjedisin. Një numër i ekspertëve ndërkombëtarë dhe parlamentarë nga rajoni vunë në dukje mësimin e nxjerrë sipas të cilit shoqëritë e rajonit duhet të forcojnë bashkëpunimin dhe të përmirësojnë këmbimin e informatave në mënyrë që të evitohen gabimet e bëra nga vendet tjera gjatë tranzicioneve të kaluara. Për më tepër, për të pasur qeverisje të mirë dhe adekuate është e domosdoshme që të sigurohet zhvillimi i një procesi demokratik kuptimplotë përmes të drejtës së qytetarëve për të pasur qasje në informata, vendim-marrje dhe drejtësi – ku të gjitha këto parashihen në Konventën e Aarhusit. Shumë nga pjesëmarrësit në konferencë pranuan se duhet gjetur baraspesha ndërmjet zhvillimit ekonomik, mirëqenies së qytetarëve dhe mjedisit të pastër. Në fund, një kornizë e mundshme për zgjidhjen e dilemës së lartpërmendur janë politikat dhe direktivat e Bashkimit Evropian mbi mjedisin, ndonëse i është lënë secilës shoqëri që në mënyrë të pavarur të zgjedhë rrugën e vet dhe mekanizmat për t'i arritur qëllimet e cekura më lart.

Në ndërkohë, zgjedhjet parlamentare më 17 nëntor, 2007 kanë ndryshuar peizazhin politik në Kosovë në mënyrë të konsiderueshme. Mund të pritët që në vitet që vijnë, sfidat mjedisore do të kalojnë lartë në agjendën politike të Kosovës. Prandaj, shpresojmë që ky botim do të mbetet si dokument referimi për mbikëqyrjen parlamentare të rregullimit mjedisor në Kosovë. Duhet përmendur se ia vlen të merren në konsideratë përvojat e parlamentarëve të vendeve fqinje.

Franklin De Vrieze
Koordinator i Iniciativës për Mbështetje Kuvendit.

Editorial	2
Qeverisja efektive e mjedisit kërkon mbikëqyrje të fuqishme parlamentare mbi ekzekutivin	3
Çështja është si të zbatohen ligjet në vendin e rrënuar e të dërmuar nga lufta	4
Zgjidhja e problemeve mjedisore kërkon reagim të organizuar	5
Kuvendi i Kosovës duhet të ketë rol udhëheqës në formulimin e politikave të ambientit	7
Informata mjedisore të dorës së parë	8
Ndikimet e ndotjes së mjedisit për zhvillimin normal të shoqërisë janë nënvlerësuar	10
Qeveria asnjëherë nuk ka diskutuar në mënyrë serioze lidhur me mjedisin	11
Mundësitë janë minimale për nevoja maksimale në fushën e mjedisit	12
Luftë ndërmjet njerëzve që dëshirojnë ta mbrojnë natyrën dhe sipërmarrjet ndërtimore	13
Zbatimi i Ligjit për Mjedisin është prioritet në Kroaci	14
Prioriteti jonë është parku tej kufitar kombëtar Malet e Sharrit	15
Bregat mjedisore në rajonin e Leposaviqit	16
Sfidat në përmirësimin e qeverisjes mjedisore	17
Dimensioni mjedisor i procesit të hyrjes në BE	18
Modeli i Qendrës Aarhus	20
Shoqëria civile mjedisore në Kosovë dhe sfidat mjedisore para saj	21
Qytetarët të pakënaqur me gjendjen e mjedisit	22



Qeverisja efektive e mjedisit kërkon mbikëqyrje të fuqishme parlamentare mbi ekzekutivin

Fjalimi hyrës në Konferencën Rajonale Parlamentare mbi Mjedisin, i Zëvendës-kryesuesit të Misionit të OSBE-së në Kosovë, z. Markku Laamanen, më 19 tetor, 2007

Kosova para vetes ka një numër të madh të problemeve mjedisore. Këto probleme kanë ngjarë, kryesisht, si pasojë e përdorimit të pakontrolluar të resurseve natyrore dhe mineraleve në dekadat e fundit, prodhimit industrial ku nuk janë marrë parasysh standardet minimale mjedisore, mungesës së sistemeve të mirëfillta të menaxhimit të mbeturinave, të cilat përqendrohen në grumbullimin mbarëkosovar të të gjitha llojeve të mbeturinave dhe sistemeve të deponimit të tyre, mungesës së sistemeve për monitorim mjedisor dhe nivelit të ulët vetëdijes sa i përket nevojës për ruajtjen e natyrës.

Kjo rezultoi me ndotje të konsiderueshme të ujit, tokës dhe ajrit, duke shkaktuar pasojë serioze të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në ekosisteme dhe shëndetin publik.

Siç e dini, Bashkimi Evropian është këmbëngulës në zbatimin e standardeve mjedisore të BE-së në tërë rajonin e Evropës Juglindore. Kjo është e mirëpritur, por një gjë e tillë mund të arrihet vetëm përmes bashkëpunimit rajonal, trajtimit të problemeve të përbashkëta dhe çështjeve mjedisore tej-kufitare. Më lejoni të ua jap disa shembuj: Termocentralet e Kosovës që veprojnë me djegie të linjtit, e që ndotin ujërat e lumit Ibër dhe si rrjedhojë Moravën dhe Danubin, të cilat derdhen përfundimisht në Detin e Zi; dhe fabrika e çimentos në Han të Elezit që ndotë ajrin deri në Shkup.

“Kush lejoi që kjo të ndodhë? Kush është përgjegjës për këtë rrëmujë? Si mund t'i zgjidhim këto probleme? “Këto janë pyetjet më të rëndomt, të cilat njerëzit e pyesin veten pasi të kenë ndodhur katastrofat mjedisore apo kur përkeqësimi i vazhdueshëm i mjedisit global paraqitet në lajme. Për shumicën, nuk është e qartë se kush “është në krye” të mjedisit dhe se si duhet të krijohen dhe zbatohen politikat e integruara mjedisore.

Që nga Samiti i Tokës në Rio de Janeiro në vitin 1992, konceptet e zhvillimit të qën-



drueshëm – zhvillim i cili siguron se përdorimi i resurseve dhe mjedisit sot nuk kufizon përdorimin e tyre nga gjeneratat e ardhshme – dhe si pasojë, qëndrueshmëria në marrëdhëniet e shumëfishta në mes të njerëzve dhe mjedisit janë bërë rregulla përbërëse të sjelljes në politikë dhe shoqëri.

Megjithatë, realizimi i një mjedisi të pastër dhe të qëndrueshëm paraqet një sfidë të madhe, për shkak të zhvillimit ekonomik, rritjes së popullatës dhe tendencës për t'u zhvendosur nga zonat rurale në qendra urbane. Konsumimi i tepruar i resurseve mjedisore është njëra nga çështjet më problematike në tentimet për të arritur një nivel më të lartë të qëndrueshmërisë, sikurse mbetet sfidë për t'u pajtuar për një baraspeshim në mes të prioriteteve ekologjike, ekonomike dhe sociale.

Mirëqenia publike dhe mjedisi, për një kohë të gjatë janë konsideruar si përgjegjësia e vetme e qeverive. Në ditët e sotme, koordinimi tradicional hierarkik i qeverive dhe administratave është zëvendësuar me mekanizma koordinimi që i ngjajnë një rrjeti dhe qasjes së orientuar drejt tregut duke inkorporuar nivele të ndryshme shoqërore.

Kufijtë e papërcaktuar funksional, strukturor dhe territorial shihen si arsye kryesore për zhvendosjen nga drejtimi hierarkik i qeverive në rregullim nga aran-

zhimet e qeverive duke përfshirë, në të njëjtën kohë, aktorë privatë dhe publikë.

Qeverisja ka të bëjë me vendime dhe mënyrë se si i marrim ato vendime. Ka të bëjë me zhvillimin e politikave të duhura dhe zbatimin efektiv, me ushtrimin e autoritetit; ka të bëjë me të qenit “në krye”. Ajo ndërlidhet me vendimmarrësit në të gjitha nivelet – menaxherë qeverie dhe ministra, afaristë, titullarë pronash, bujq, OJQ dhe konsumatorë. Thënë me pak fjalë, ka të bëjë me atë se kush është përgjegjës, si e morën ata pushtetin në duar, dhe kujt i japin llogari.

Parakusht për një qeverisje efektive mjedisore është mbikëqyrja e fuqishme e politikave ekzekutive në mënyrë që, të arrihet një qeverisje efektive demokratike. Kjo ka nevojë për përfaqësues të përgjegjshëm të zgjedhur në të gjitha nivelet, si dhe në Komisione efektive të nivelit qendror, siç është Komisioni për Mjedis, në gjendje për të përkrahur zhvillimin e politikave të qëndrueshme mjedisore, shqyrtimin e ligjeve dhe rregulloreve të propozuara, monitorimin e efikasitetit të zbatimit të legjislacionit të miratuar, ndërmarrjen e dëgjimeve hetuese dhe për të luajtur një rol kyç në rrjetet rajonale.

Në OSBE ekziston një mirëkuptim i asaj, që zhvillimi i qëndrueshëm mjedisor është çelësi i krijimit të sigurisë dhe stabilitetit vendor dhe rajonal. Ai shpeshherë paraqet edhe çështje të nënvlerësuar të të drejtave të njeriut, meqë ndotja dhe përdorimi i paqëndrueshëm i resurseve të çmueshme ndikon në radhë të parë, në grupet e rrezikuara të shoqërisë siç janë pakicat, fëmijët dhe të moshuarit.

OSBE-ja synon që, përmes kësaj konference të tregojë se si përparimi i mëturshëm në këto fusha, siç janë pjesëmarrja e publikut, llogaridhënia, mbikëqyrja parlamentare, sundimi i ligjit, ofrimi i shërbimeve publike dhe decentralizimi, mund të ndihmojnë në përfitime më të gjera në kuptim të qeverisjes së mirë dhe përkujdesjes mjedisore.

Çështja është si të zbatohen ligjet në vendin e rrënuar e të dërrmuar nga lufta

Fjala përshëndetëse e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, z. Sabri Hamitit, në Konferencën Rajonale Parlamentare për Mjedisin (Mandati i Kuvendit 2004-2007)



Kam kënaqësinë e nderin të ju shpreh mirëseardhje në Kosovë, duke qenë i kënaqur që Kuvendi i Kosovës, në bashkëpunim me OSBE-në, organizon këtë Konferencë Regjionale Parlamentare.

Parlamenti i Kosovës, si organi më i lartë përfaqësues, po zhvillohet në Kuvend demokratik me procedura dhe me funksion: duke hartuar ligje e duke përcjellë zbatimin e tyre.

Kuvendi i Kosovës, si gjithë shoqëria, tashti është para dy sprovave të mëdha, zgjedhjeve kombëtare e lokale dhe definimit të statusit politik të Kosovës, në bazë të vullnetit të qytetarëve.

Kosova e pavarur e demokratike tanimë është çështje ekzistenciale për qytetarët e Kosovës, dhe krijuese e stabilitetit në rajon e më gjerë. Kosova e shqiptarët dhe qytetarët e saj gjeografikisht, historikisht e kulturalisht janë evropiane dhe dëshirojnë të bëhen evropiane dhe politikisht nëpërmjet integritimeve e standardeve evropiane.

Kjo konferencë, pos rëndësisë që ka për trajtimin e problemit mjedisor (ambiental), ka edhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërparlamentar në rajon.



Kuvendi i Kosovës, duke pasur një konsensus të plotë për çështjet mjedisore, ka aprovuar një mori ligjesh për ambientin, duke pasur parasysh rrethanat e vendit e standardet evropiane. Çështja është si të zbatohen ligjet në vendin e rrënuar e të dërrmuar nga lufta.

Çështja e ambientit është çështje e jetës dhe ka dimensionet konkrete e universale, në këtë vështrim i shohim me dobi të madhe observimet dhe përvojat që do të shpalojnë këtu për dy ditë punë.

Toka, uji e ajri, ashtu si edhe liria, janë për të gjithë dhe, duke ruajtur këto, ruhet ambienti i shoqërisë humane. Këto nuk janë çështje vetëm për përfaqësuesit, por për të gjithë qytetarët.

Duke ju përshëndetur edhe një herë, në emër të Kuvendit të Kosovës, ju dëshiroj qëndrim të këndshëm në Kosovë, ju dëshiroj sukses në Konferencë dhe ju lë kohën që të shfaqni idetë dhe përvojat tuaja.

19 tetor, 2007



Zgjidhja e problemeve mjedisore kërkon reagim të organizuar

Intervistë me Ministrin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Z. Ardian Gjini (Qeveria e Kosovës 2004-2007).



ASI: Si e vlerësoni gjendjen në fushën e mjedisit në Kosovë?

Ardian Gjini: Si një problem shumë të madh të trashëguar, ku me dekada përkeqësimi mjedisor është injoruar duke na bërë një nga rajonet me ndotje më të lartë. Megjithatë, jemi duke e sfiduar këtë ndotje me një përvojë relativisht të re institucionale dhe të stafit. Nëse vlerësohet gjendja pas lufte deri më sot janë arritur shumë përmirësime, por kemi aq shumë për të bërë për vite me radhë saqë nuk mund të i lejojmë vetit një vetëkënaqësi. Probleme të cilat ende e rëndojnë gjendjen mjedisore te ne vazhdojnë të jenë: trajtimi i ujërave të zeza, kualiteti i ajrit, ruajtja e biodiversitetit, trajtimi i mbeturinave e çështje të tjera. Jemi të vetëdijshëm për faktin që ato nuk trajtohen në mënyrë të duhur, prandaj ndotja e ambientit e shkaktuar nga aktivitetet e mëparshme industriale është me të vërtetë e rrezikshme. Problem tjetër paraqesin edhe ndërtimet e paplanifikuara si dhe shfrytëzimi i pamjaftueshëm i resurseve natyrore

ASI: Çfarë keni përmirësuar në fushën e mjedisit që nga ardhja juaj në pozitën e Ministrit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor? Çka do të dëshironit të bënit ndryshe?

AGJ: Pasi që Kosova ndodhet në këtë gjendje parastatutore dhe angazhimi im në këtë proces përmes grupit politik strategjik pranë delegacionit të Kosovës për negociata ka qenë mjaft i ngjeshur, nuk kam mundur të jem plotësisht i kyçur në punën e Ministrisë. Megjithatë, Ministria ka arritur të plotësojë kornizën legjislative, janë dhënë lejet e para ujore, është finalizuar Plani Hapësinor i Kosovës, janë siguruar donacione në vlerë mbi 30 milion euro etj.

Është shumë e qartë se nuk kemi mundur të bëjmë edhe shumë pasi që kjo është e njëjtë më të gjitha vendet në tranzicion. Edhe pse ende jemi shoqëri në tranzicion dhe me status politik të pazgjidhur, në një periudhë të përpjekjeve për ngritje të ekonomisë, të privatizimit, të sundimit të ligjit dhe të avancimit të proceseve demokratike në përgjithësi, ne po mundohemi që nëpërmes përforcimit të legjislaturës mjedisore të fuqizojmë instrumentet mjedisore siç janë: vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM); vlerësimi strategjik mjedisor (VSM); preventiva dhe kontrolli i integruar i ndotjes (IPPC), në mënyrë që të sigurojmë respektimin e parimeve mbi zhvillimin e qëndrueshëm.

Një hap tjetër të cilin e ka marrë Ministria jonë është edhe mbyllja e deponive

të vjetra dhe përgatitja e projekteve për mbylljen e deponive të tjera "ilegale".

Po kështu, Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis ka kaluar në Kuvend, plan i cili definon mekanizmat, instrumentet, mjetet, zbatuesit dhe afatet për zbatimin e strategjisë mjedisore. Me këtë dokument futen në lëvizje parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, nevojat dhe interesat e Kosovës për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, nevojat dhe interesat lokale, interesat grupore dhe individuale, parimet e stabilizimit dhe kërkesat për bashkëngjitje në Bashkësinë Evropiane, si dhe bashkëpunimi bilateral dhe marrëveshjet regionale.

Një sfidë e madhe për MMPH-në dhe Kosovën në vazhdimësi është përmirësimi i mjedisit, i cili është i nevojshëm, jo vetëm për shëndetin e qytetarëve, por edhe integrimin dhe harmonizimin me standardet e BE-së.

ASI: Çfarë keni ndërmarrë lidhur me çështjet e ndotjes në Kaçanik dhe Obiliq?

AGJ: Ligji i ajrit është miratuar në parlament, po ashtu edhe aktet nënligjore si: Udhëzimi Administrativ për Normat e Shkarkimit në Ajër nga Burimet Stacionare, ku sipas nenit 75 pika (1) Jo më

vonë se deri me 31. 03. 2008, operatorët duhet të hartojnë "Programe për reduktimin efikas" të emisionit të gazrave (zvogëlimin e emisionit të SO₂ dhe NO_x dhe pluhurit) nga impiantet ekzistuese. Kriteret të bashkëpunimit për hartimin e "Programit për reduktimin efikas" do t'i përcakton Ministria, ndërsa sipas pikës (5) operatorët obligohen që në bazë të planeve për reduktimin e ndotjes t'i plotësojnë standardet e BE deri me 31. 12. 2017.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe KEK-u çështjen e fenolit e kanë identifikuar si 'pikë të nxehtë' dhe me qëllim të zvogëlimin të rrezikshmërisë nga to. Gjithashtu inspektorët e inspektoratit të MMPH-së në vazhdimësi kryejnë inspektime në këtë repart me qëllim të përcjelljes së gjendjes së këtyre mbetjeve fenolike.

Sa i përket monitorimit dhe kontrollit të emisioneve në "Sharcem", me qëllim të verifikimit të nivelit të emisioneve dhe përbushjes së obligimeve ligjore që dalin edhe nga obligimi i posedimit të pëlqimit mjedisor, "Sharrceci", përveç kontrollit të vazhdueshme të emisioneve përmes pajisjeve për deplunim të vendosura në burimet potenciale, nga viti 2004 bën matjet periodike 2 herë në vit dhe atë për komponente standarde në oxhakun e furrës, si njëri prej burimeve kryesore të shkarkimeve të gazrave dhe pluhurit, po ashtu një herë në vit testohen edhe metale të rënda në emisionet e pluhurit nga oxhaku furrës. Në këtë drejtim mund të theksojmë se vlerat e emisioneve absolute të CO₂ janë më të vogla për 13 % ndaj rritjes së prodhimit të çimentos në krahasim me vitet paraprake, po ashtu edhe ujërat e procesit të bëra gjatë vitit 2007 nga ana e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës nuk tejkalojnë VML sipas direktivës 152/1999 të BE për ujëra të shkarkuar urbane dhe industriale.

ASI: Janë hartuar pothuajse të gjitha ligjet bazike mjedisore. Si e vlerësoni zbatimin e tyre dhe funksionimin e auto-

riteteve përkatëse?

AGJ: Për vitin 2007 janë nxjerr pothuajse të gjitha ligjet sipas planit legjislativ 2007. Zbatimi i këtyre ligjeve besojmë se do të fillon së shpejti, ndërsa funksionimi i autoriteteve nuk është i mjaftueshëm.

Kemi identifikuar se sado që jemi funksional në hartimin e kornizës legjislative vazhdojmë të hasim në probleme gjatë fuqizimit dhe zbatimit të këtyre ligjeve. Andaj në bashkëpunim me Agjencinë Evropian për Rindërtim jemi në fillimin e një projekti për të ndihmuar inspektoratin e ministrisë si dhe komunat në implementimin e këtyre ligjeve.

Por jemi të vetëdijshëm se kemi ngecje në funksionalizimin e gjykatave në rastet mjedisore.

Zbatimi i Ligjit në fushën e mbrojtjes së mjedisit vështirësohet si pasojë e mungesës të mjeteve financiare për ndërtimin e impianteve për pastrimin e ujërave industriale dhe ujërave të zeza për një periudhë të gjatë; mungesës së kompetencave për menaxhimin e mbeturinave; mbrojtja e mjedisit nuk është prioritet në një shoqëri në tranzicion; mungesa e stafit profesional në fushat specifike të mbrojtjes së mjedisit; numri i vogël i inspektorëve (janë vetëm 5 inspektorë për fushën e mjedisit dhe ujërave).

ASI: Sa janë të gatshme institucionet e Kosovës për përbushjen e marrëveshjeve ndërkombëtare mbi mjedisin. Sidomos në rastet e ndotjes ndërkufitare?

AGJ: Është e qartë se problemet mjedisore nuk njohin kufij shtetërorë. Prandaj, zgjidhja e problemeve mjedisore kërkon reagim të organizuar politik, profesional dhe të koordinuar, jo vetëm në nivel vendi, por edhe në nivel regional e ndërkombëtar.

Kosova ka treguar gatishmërinë për bashkëpunim rajonal në fushën e mjedisit duke i dhënë përgjigje pozitive dhe duke inkurajuar implementimin e programeve

dhe projekteve të caktuara në nivel rajonal. Edhe pse deri me tani iniciativa të tilla nuk kanë qenë të mjaftueshme, megjithatë do të përmendja këtu iniciativën ENVSEC (Environmental Security Initiative), program ky i përkrahur nga UNEP, UNDP, NATO, OSBE, e të tjerë, në lidhje me bashkëpunimin rajonal për menaxhimin e zonave malore ndërkufitare, por edhe aspekte të tjera mjedisore.

ASI: Cilat janë prioritetet e Ministrisë në pesë vitet e ardhshme në fushën e mbrojtjes së mjedisit?

AGJ: Kryesisht do të duhej të ishte ngritja e vetëdijes institucionale në trajtimin e çështjeve mjedisore në kuadër të politikave zhvillimore sektoriale, si dhe ngritja e vetëdijesimit dhe pjesëmarrjes publike në procesin e vendimmarrjes për çështjet mjedisore. Prioritetet e caktuara në bazë të kornizës afatmesme janë: zhvillimi i kornizës ligjore dhe institucionale për sektorin e mjedisit; parandalimi dhe ulja e ndotjes së mjedisit, përmes qasjes integrale për kontrollin e ndotjes; mbrojtja e biodiversitetit, trashëgimisë natyrore dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore; bashkëpunimi dhe pjesëmarrja aktive në iniciativat evropiane dhe ndërkombëtare për sektorin e mjedisit; ngritjen e vetëdijesimit, arsimimit dhe pjesëmarrjes publike në procesin vendimmarrës për çështjet mjedisore.

Po kështu ne kemi hartuar planet sektoriale për ujëra dhe mjedis në kuadër të Planit Zhvillimor Strategjik të Kosovës, ku kryesisht është harmonizimi i legjislacionit me direktivat evropiane, zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë, mbrojtja e resurseve ujore, trajtimi i ujërave të zeza, ngritja e rrjeteve monitoruese, menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme, hartimi i planeve sektoriale etj.

Intervistoi,
Artan Canhasi,
Misioni i OSBE-së në Kosovë

Kuvendi i Kosovës duhet të ketë rol udhëheqës në formulimin e politikave të ambientit

Nga: Lodewijk Vanoost, Misioni i OSBE-së në Kosovë



Revolucioni industrial ka sjell mirëqenie të pashembullt për një numër të madh njerëzish kudo në botë. Progresi shkencor ka zgjatur në mënyrë të ndjeshme jetëgjatësinë. Kaluan disa dekada para se njerëzit filluan të kuptojnë se ky revolucion kishte edhe efekte anësore. Kudo në Evropën perëndimore njerëzit filluan të binden se shoqëria jonë industriale duhej të pastrohej, në kuptim e plotë të fjalës. Ndërsa lëvizja për mjedis të sigurt dhe të pastër së pari filloi në nivel më themelor, liderët politik u përfshinë në këtë betejë për të bashkërenduar prioritetet ekonomike dhe ekologjike.

Në fillim, ky vetëdijësim i ri u bë i dukshëm me daljen në skenë të partive të të gjelbërve dhe ekologjike, dhe zgjedhjes së tyre në parlamentet kombëtare kudo në Evropë. Por, gradualisht ambienti u bë çështje e të gjitha partive politike. Sot, çështja është në ballë të debateve politike në të gjitha vendet e Evropës.

Në fakt, mund të thuhet se ambienti është pjesë thelbësore e punës së parlamentarëve. Të gjitha parlamentet kanë komisionet e tyre specifike mbi ambientin. E njëjta vlen edhe për nivelin qeveritar. Kosova ka gjithashtu një Ministri për çështje që kanë të bëjnë me ambientin.

Megjithatë, është parlamenti ai që duhet të luaj rolin udhëheqës në formulimin dhe hartimin e politikave të ambientit. Duke qenë përfaqësues të popullit të tyre, parlamentarët janë më afër nevojave dhe brengave të zgjedhësve të tyre lokal, se sa që është Ministri. Ministri duhet të përkujdeset për mirëqenien e përgjithshme. Por, parlamentarët janë ata që kanë njohuri dhe i kuptojnë problemet lokale.

Sfida për Kuvendin e Kosovës është jashtëzakonisht e madhe. Së pari, është çështja e Termocentraleve të Obiliqit. Si të bashkërendohet nevoja për të siguruar energji elektrike 24 orë në ditë për shkollat, spitalet, lokalet afariste dhe shtëpitë me nevojën urgjente për të pastruar procesin e prodhimit të energjisë, kjo është një çështje me të cilën duhet të ballafaqohet Kuvendi i Kosovës. Minierat e Trepçës konsiderohen të jenë ndër vendet apo pikat e nxehta me ndotje më të madhe në Evropë. Më pas, është dhe çështja e ujit të pijshëm.

Duke iu falënderuar energjisë të popullit të Kosovës, rindërtimi pas luftës u bë me një shpejtësi të paparë dhe me sukses të pamohueshëm. Kjo, gjithashtu, ka krijuar probleme të reja. Mbeturinat po grumbullohen buzë rrugëve të të gjitha fshatrave të Kosovës, lumenjtë dhe fushat

janë të ndotura me mbeturina të plastikës. Nëse Kosova nuk merret shpejtë me këto probleme të reja, ato do të bëhen barrë për zhvillimin social dhe ekonomik.

Këto nuk janë thjesht çështje luksi, e as që janë vetëm çështje të ambientit. Këto janë çështje të shëndetësisë. Shumë kritikë do të theksojnë se kjo do të kërkojë shpenzimin e shumave të mëdha. Megjithatë, çështja nuk qëndron aty se a ka mundësi Kosova të shpenzojë dhe paguajë për mjedis të pastër, por se a mund t'ia lejoj vetës mos të paguaj për këtë. Pasojat e ndotjes së tanishme ndjehen çdo ditë kur prindërit duhet të paguajnë shpenzimet mjekësore për fëmijët e tyre për arsye të sëmundjeve të shkaktuara nga ndotja.

Debati mbi ardhmërinë e shoqërisë së Kosovës do të jetë, mes tjerash, debat mbi mjedisin. Kjo do të bëhet element thelbësor i politikave. Çdo herë e më shumë, votuesit do të votojnë për parti të caktuara duke u bazuar në programin e tyre ekologjik. Kuvendi i Kosovës është vendi ku debati duhet dhe do të zhvillohet. Votimi për ligjet është pjesë themelore e strukturimit të politikave të ambientit. Kontrollimi i qeverisë është një pjesë tjetër. Parlamentarët kanë obligim të formulojnë një vizion të së ardhmes, ku përfshihet edhe lufta për një ambient të pastër.

Kjo është një sfidë për parlamentarët në të gjitha vendet e Evropës. Nuk është betejë e lehtë. Megjithatë, Kosova mund të përfitojë nga përvoja e kolegëve të tyre nga vendet tjera. Prandaj, Konferenca Rajonale Parlamentare mbi Ambientin, e datës 19-21 tetor, ishte një nismë shumë e mirë për t'u përsëritur edhe nga parlamenti i ri pas 17 nëntorit.

(Lodewijk Vanoost nga 1995 deri më 2003 ka qenë deputet i Parlamentit të Belgjikës, Dhoma e Përfaqësuesve. Gjatë kësaj kohe, ai ishte Zëvendës i Kryetarit të Kuvendit. Që nga maji 2005, ai punon si Këshilltar i Lartë në Misionin e OSBE-së në Kosovë, së pari me detyrë pranë Komunitetit të Rahovecit, ndërsa që nga janari 2006, në zyrën e Kryeministrit).

Informata mjedisore të dorës së parë

Nga Rifat Krasniç, Kryetar i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i Kuvendit të Kosovës (Mandati 2004 – 2007)





Anëtarët e Komisionit për Mjedis të Kuvendit të Kosovës gjatë vizitës së tyre në termocentrale

Gjatë vitit 2007, Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i Kuvendit të Kosovës ka filluar bashkëpunimin në mënyrë formale me Misionin e OSBE-së në lidhje me çështjet mjedisore. Një mbështetje e tillë synon të zhvillojë aftësitë e Komisionit për të përmbushur më me lehtësi obligimet dhe përgjegjësitë e tij në shqyrtimin e ligjeve, mbikëqyrjen e Ministrive gjegjëse si dhe realizimin e vizitave brenda dhe jashtë vendit. Në periudhën qershor-korrik 2007, Komisioni Parlamentar për Mjedis i Kuvendit të Kosovës ka realizuar një sërë vizitash në katër komuna të identifikuara si “pika të nxehta” mjedisore: Obiliqin, Mitrovicën, Glllogocin dhe Prizrenin.

VIZITA NË KORPORATËN ENERGETIKETËKOSOVËS (KEK)

Pas vizitës, Komisioni konstatoi që pjesa më e vlefshme e punës që aktualisht po ndërmerret nga KEK-u është rikultivimi i tokës së degraduar nga mihjet sipërfaqësore, si dhe rigjenerimi gradual i saj. Deri tani, sistemi i moni-



torimit të ndotjes mjedisore është themeluar në pajtim me direktivat dhe standardet evropiane. Zyrtarët mjedisorë të KEK-ut informuan Komisionin që Traktati i Selanikut tanimë ka përcaktuar një afat për mbylljen e centraleve të mëdha me djegie të TC Kosova A, që është 2017-a. Gjithashtu, Zyrtarët mjedisorë ofruan informata të hollësishme mbi të dhënat dhe sfidat mjedisore të përballura nga KEK-u. Sfida më madhore është transportimi i linjtit, i cili bëhet me sistem të hapur të shiritave bartës, i cili rezultoi në emetime të pluhurit dhe ndotjes në vendbanimet përreth. Ngjashëm, një sfidë tjetër mjedisore është shkarkimi i ujërave të zeza industriale nga centralët në lumenj pa trajtim adekuat, gjë që në anën tjetër përfaqëson ndotësin kryesor të lumenjve-ujërave. Gjatë vizitës në KEK, Komisioni u përball me teknologjinë e vjetruar në këto stabilimente, sidomos në rastin e TC Kosova A, ku kushtet e punës janë mjaft të këqija për shkak të sasisë së madhe të pluhurit.

VIZITA NË KOMPLEKsin METALURGJIK TË TREPÇËS

Komisioni ka vizituar edhe Kompleksin Metalurgjik të Trepçës, i cili përfshin 8 zona me më shumë se 200 hektarë, që përmbajnë rreth 60 milionë tonë mbeturina, si dhe ujëra acidike të shkarkuara nga minierat. Menaxhmenti i Trepçës informoi Komisionin mbi gjendjen aktuale të Trepçës dhe synimet për të ardhmen. Komisioni u informua mbi punën e bërë në këto stabilimente, duke filluar prej pajisjeve të riparuar, investimet dhe deri tek proceset e reja teknologjike. Zyrtarët mjedisorë informuan që gjatë vitit 2002, UNMIK-u u dash të intervenojë për shkak të ndotjes dhe çështjeve mjedisore. Ky stabiliment kishte shpenzuar rreth 3-4 milionë Euro në çështje mjedisore. Tanimë, sistemi i monitorimit të cilësisë së ajrit është ri-vendosur për rajonet e Mitrovicës, Leposaviqit dhe Kishnicës nga KFOR-i dhe Organizata Botërore e Shëndetit. Shërbimet profesionale të Trepçës përfshijnë edhe monitorimin e ujit.

VIZITA NË PARKUN E SHARRIT

Gjatë vizitës në “Parkun e

Sharrit”, pjesa që i përket Komunës së Prizrenit, Komisioni ishte dëshmitar i vështirësive të menaxhimit (paralel) të dy ministrive (MBPZHR dhe MMPH). Komisioni vërteti mungesë të angazhimeve rreth mirëmbajtjes dhe luftimit të sëmundjeve drusore të cilat vazhdimisht shkatërojnë drunjtë të cilat thahen dhe duken sikurse të ishin djegur. Komisioni konstatoi se pastrimi i pyjeve dhe prerjet duhet të bëhen domosdo nëse dëshirohet të shpëtohet kjo pasuri natyrore.



VIZITA NË MINISTRINË E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i Kuvendit të Kosovës në vizitën e paraparë në Ministrinë e Mjedisit u interesua për çështjet më aktuale dhe që presin zgjedhje në Kuvendin e Kosovës, sidomos projektligjet të cilat duhet të miratohen në leximin e dytë por edhe ato që duhet të mbërrijnë në Kuvend. Çështjet tjera, Ministri Gjini i cilësoi si çështje buxhetore, sidomos mosrealizimi i master planit të

Kosovës për ujërat e zeza për të cilën duhen mjete shtesë.

Takimi gjithashtu u përqendrua në problematikën e strategjisë për mjedisin e cila në qeveri është miratuar më 2004, por jo në Kuvend, përkundër dispozitës së parashikuar me Ligjin përkatës. Në anën tjetër është hartuar plani, çka do të thotë se kjo strategji nuk ka bazë ligjore. Zyrtarët e Ministrisë sqaruan se kjo ka ndodhur për shkak se deputetët nuk e kanë pasur të qartë si të veprohet me dokumente të tilla si Strategjia të cilat nuk janë ligje. Komisioni nënvizoi se në Kastriot dhe Mitrovicë shihet qartë se ka munguar tërësisht dora e ministrisë. U kërkua të bëhet monitorimi i gjendjes së mjedisit.

Foto lajme nga Konferenca Rajonale Parlamentare mbi Mjedisin



Ndikimet e ndotjes së mjedisit për zhvillimin normal të shoqërisë janë nënvlerësuar

Intervistë me Oliver Ivanović, anëtar i SLKM-së në Kuvendin e Kosovës (Mandati i Kuvendit 2004 – 2007).



Oliver Ivanović: Mjedisi si temë është lënë pas dore. Vlerësimi i përgjithshëm për tërë Kosovën është që, në një situatë ku mbizotërojnë tema të nxehta politike, ne nuk po e vërejmë se mjedisi jonë po kërcënohet, se ka gjithnjë e më shumë ndotje dhe se ndikimet e ndotjes së mjedisit në zhvillimin normal të shoqërisë janë nënvlerësuar, posaçërisht në zhvillimin e të rinjve.

Në veri të Kosovës, ndotja e ambientit ka qenë tradicionalisht e lidhur me Trepçën, e cila nuk punon që nga viti 2000, por kjo nuk do të thotë që me të është ndalur (apo zvogëluar) edhe ndotja e ambientit. Nuk ka ndotje aktive e ajrit por kjo nuk do të thotë që rreziku është më i vogël, për shkak të produkteve anësore dhe deponive të tyre. Këto mbeturina përmbajnë koncentrim të lartë të metaleve të rrezikshme, të cilat në e

marrim përmes frymëmarrjes, ujit dhe gjërave ushqimore.

Jam i zhgënjyer nga fakti që misioni ndërkombëtar në Kosovë nuk i ka kushtuar shumë më shumë vëmendje kësaj çështjeje pasi që ata vijnë nga shtetet Evropiane ku veprime të tilla të papërgjegjshme sanksionohen shumë ashpër.

Do ta përmendja si shembull ndërtimin e deponisë në "Balaban" (afër Banjskës), e cila gjendet shumë afër lumit Ibër dhe rrugës kryesore, dhe në poshtë rrjedhës ky lumë përdoret për furnizim me ujë të pijshëm. Pemët që gjenden afër deponisë, dhe poshtë rrjedhës së lumit i ngjajnë pishave të krishtlindjeve, të dekoruara me qese plastike. Kraleva dhe qytezat poshtë rrjedhës së lumit ballafaqohen me vështirësi serioze, dhe nuk po e përjashtoj motivin politik për një vendim të tillë, ndonëse

është e mundshme që janë të përfshira interesat personale të atyre që dëshirojnë fillimin e investimeve të mëdha në dem të shëndetit të popullatës së Banjskës, Soqanicës, Leposaviqit dhe Leshkos.

Cilat janë projektet e suksesshme mjedisore në komunitetin tuaj?

OI: Nuk ka projekte të organizuara, por ka disa shembuj të suksesshëm. Dëshiroj të shpreh mirënjohje për shoqatën e alpinistëve "Zmaj", e cila me vetiniciativë dhe me mbështetje të OSBE-së ka ndihmuar në heqjen e mbeturinave nga bregu i Zveqanit dhe shpresoj që kjo do të shërbejë si shembull për të tjerët, pasi që sasia e mbledhur e xhamit, plastikës letrës dhe metalit mund tu shitet atyre që u nevojitet për procesin e prodhimit, dhe kështu mund të gjenerojë edhe fitim. Përfitimi i parë dhe kryesor është në ngritjen e vetëdijes në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e tij. Mjedisi do të lirohet nga këto mbeturina dhe kështu do të lirohet edhe toka. Do të kishte përfitime për shkollat, shoqërinë, shoqatat, OJQ-të të cilat do të kompensoheshin për punën e tyre.

Unë personalisht do të jepja kontribut për këtë!

ASI: Si e vlerësoni punën e institucioneve dhe shoqërisë civile në komunitetin tuaj në fushën e mjedisit?

OI: Shumë dobët! Për shkak të oportunitizmit të madh politik, ata ose nuk flasin ose flasin për këtë çështje, ndonëse në qarqe të mbyllura politike, gjë që nuk mjafton për shoqërinë e cila e sheh këtë si problem. Debatet publike, diskutimet, bisedat e hapura do ta ngritin vetëdijen e shoqërisë për rëndësinë e tij, herët a vonë.

Duhet urgjentisht të bëhet diçka përkritazi me ndotjen radioaktive, pasi që dihen vendet ku është bombarduar. Individët dhe institucionet kanë bërë hulumtime dhe kanë gjetur që informatat e tilla me të vërtetë ekzistojnë, mirëpo mbahen shumë të fshehura nga publiku.

ASI: A mund t'i përmendni tri prioritetet kryesore për pesë vitet e ardhshme në fushën e mjedisit?

OI: Së pari duhet ta shohim nivelin e ndotjes së mjedisit. Ne duhet të zhvillojmë veprimtari me përfshirje të fëmijëve nga shkollat në mbledhjen e letrës dhe shisheve të plastikës nëpër qytete dhe në anët e rrugëve. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet pastrimit të liqenit të Gazivodës dhe sipërfaqeve tjera me ujë. Projektligji për mbrojtjen e mjedisit (nëse miratohet, ne duhet të insistojmë në zbatimin e tij)

Intervistoi,
Ivana Lazarevic, Misioni i OSBE-së
në Kosovë

Qeveria asnjëherë nuk ka diskutuar në mënyrë serioze lidhur me mjedisin

Intervistë me deputeten Selviqe Halimi (PDK) – anëtare e Komisionit Parlamentar për Mjedisin i Kuvendit të Kosovës
(Mandati i Kuvendit 2004 – 2007)

ASI: Sipas jush, cilat janë tri problemet kryesore në fushën e mjedisit?

S. H: Si problem kryesor parqitet mos plotësimi i legjislationit dhe moszbatimi i ligjit për mbrojtjen e mjedisit si dhe mosndarja e kompetencave apo paqartësia, se cilat janë kompetencat në nivelin qendror dhe atë lokal sa i përket mbrojtjes së mjedisit. Kjo mund të ketë mbetur kështu qëllimisht, që të mos fokusohet se mbi kë bie përgjegjësia për zbatimin e politikave mjedisore. Mendoj se diku 80% e legjislationit përshkruan kompetencat e drejtpërdrejta të pushtetit lokal. Si rrjedhojë, është shqetësuese mospërcjellja e zbatimit të ligjeve nga ana e Ministrisë dhe nga ana e nivelit komunal.

Problem tjetër është ndotja e skajshme e ajrit në Kosovë. Deri më tani nuk janë marrë hapa adekuate së paku për zvogëlimin e lirim të ndotësve të ajrit. Problem shtesë është papastërtia e ujit gjegjësisht ndotja e ujërave. Domosdoshmërisht, me ndotjen e ajrit dhe të ujërave, vjen edhe ndotja e tokës. Shpreh shqetësimin tim se deri më tash, edhe përkundër nxjerrjes së disa raporteve nga ana e Ministrisë lidhur me statistikën e ndotjes së mjedisit, ato nuk janë bërë publike për opinion. Publikimi i raporteve lidhur me gjendjen e mjedisit, faktorët që ndikojnë në ndotjen

e mjedisit dhe rrezikun potencial është i domosdoshëm. Ngase, komuniteti do të ishte më i kujdesshëm me ndikimet e mundshme në mjedis gjatë aktiviteteve individuale ose grupe, me qëllim të zhvillimit të bizneseve dhe aktiviteteve tjera të ngjashme.

ASI: Cilat sipas jush janë të arriturat kryesore në fushën e mjedisit?

S. H: Të arriturat kryesore në fushën e mjedisit janë të lidhura me legjislationin i cili është mjaftë mirë i harmonizuar me atë të Unionit Evropian. Por, shqetësuese është moszbatimi i tyre. Më pastaj mendoj se edhe Ministria e Mjedisit ka filluar të vetëdijësohet, gjegjësisht zyrtarët në Ministri kanë filluar të marrin më seriozisht këto çështje, ndonëse ky seriozitet shihet vetëm në teori dhe është larg nga praktika. Megjithatë, mendoj se edhe njohuritë teorike në fushën e ndotjes së mjedisit ndoshta në fillim do të mjaftonin.

ASI: Si e vlerësoni punën e Qeverisë në fushën e mjedisit?

S. H: Unë asnjëherë nuk kam parë ose nuk kam informata se në mbledhjet e Qeverisë së Kosovës është diskutuar në mënyrë serioze lidhur me mjedisin në Kosovë, përjashtoj këtu diskutimet gjatë procesit të parashtrimit të ligjeve në Kuvendin e Kosovës nga ana e Qeverisë. Përderisa e gjithë Qeveria e Kosovës, duke fil-



luar nga vetë Kryeministria dhe resorët tjerë të Qeverisë nuk e kuptojnë që çdo aktivitet i tyre në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë ndikon në mjedis, nuk mund të themi se Qeveria e ka marrë seriozisht çështjen e mbrojtjes së mjedisit.

ASI: Cilat sipas jush janë tre prioritetet kryesore në fushën e mjedisit?

S. H: Si anëtare e Komisionit përkatës parlamentar për Mjedisin, prioritet për mandatin e ardhshëm duhet të jetë kompletimi dhe zbatimi i ligjshmërisë, që do të thotë ndërmarrja e aktiviteteve të ne harmoni me ligjin dhe vepime të rrepta për zbatimin e ligjit; ndarja e kompetencave në mes nivelit qendror dhe

atij lokal lidhur me mbrojtjen e mjedisit; bartja e kompetencave nga UNMIK-u lidhur me menaxhimin e mbeturinave dhe ujërave tek institucionet vendore. Këto janë prioritetet sa i përket legjislationit. Prioritet tjetër do të duhej të ishte që Qeveria të kuptojë se duhet të qeverisë me mjedisin. Prioritet i tretë është bashkëpunimi i ngushtë i institucioneve kompetente për mjedisin me komunitetin dhe kjo bëhet vetëm duke bërë hapjen e sektorëve për ruajtjen e mjedisit në kuadër të çdo komune në Kosovë.

Thëne ndryshe, po nuk u kujdesëm për mjedisin, do ta shkatërrojmë vetveten!

Intervista punuar nga Blerim Vela,
Misioni i OSBE-së në Kosovë

Mundësitë janë minimale për nevoja maksimale në fushën e mjedisit

Intervistë me Z. Lulzim Zeneli, Zëvendëskryetar i parë i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim hapësinor të Kuvendit të Kosovës, lidhur me gjendjen e mjedisit në Kosovë (Mandati i Kuvendit 2004-2007).

ASI: Si anëtar i Komisionit për Mjedis në Kuvendin e Kosovës, si e vlerësoni situatën në fushën e mjedisit në Kosovë?

Lulzim Zeneli: Gjendja e mjedisit në Kosovë vlerësohet si alarmante, për faktin se ndodhemi në një pozitë ku si institucion po përjetojmë periudhën e tranzicionit, ku institucionet kanë përgjegjësi shumë të madhe karshi krejt këtij fenomeni ndërsa mundësitë aktuale, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në ndërrimin e kësaj gjendjeje janë minore në krahasim me krejt nevojat që ngërthen në veti problematika mjedisore. Kosova është ballafaqur dhe ballafaqohet me një ndotje enorme. Kësaj çështjeje nuk i është kushtuar rëndësi në 15 vjetët e fundit. Gjatë sistemit komunist, në Kosovë është bërë një eksploitim i dhunshëm i të gjitha resurseve dhe pasurive natyrore nëntokësore, pa i kushtuar vëmendje pasojave të mundshme në mjedis. Në anën tjetër kemi pasur një politikë e cila nuk ka kushtuar vëmendje potencialeve regjeneruese të natyrës dhe ruajtjes së diversitetit. Dhe me të gjitha këto së bashku, mund të përfundojmë se gjendja në Kosovë sa i përket fushës së mjedisit është e rëndë dhe kërkon një qasje urgjente që të parandalohet ndotja e mëtejme mjedisit, e cila tash për tash është në suaza të asaj kritike.

ASI: Cilat janë tri problemet kryesore të mjedisit jetësor në Kosovë?

LZ: Problemi kryesor aktual i mjedisit është ndotja industriale, hedhurinat industriale që janë akumuluar në një kohë të gjatë dhe nuk kanë pasur një trajtim adekuat. Si rezultat i kësaj ka ardhur edhe të ndotja e ujit, në Kosovë nuk kemi asnjë sistem të caktuar për trajtimin e ujërave të hedhur dhe

mendojmë se menjëherë duhet të fokusohet vëmendja në këtë krizë. Hedhurinat industriale, që përmbajnë në veti metale të rënda me potencial të lartë toksik, atëherë efektet e ndotjes nuk do të shfaqen jo vetëm tek popullata por edhe tek bota bimore dhe shtazore. Kjo qarkullon si një cikël, ku pasojat do të jenë zingjyrore. Ne mendojmë se trajtim i hedhurina industriale, duhet të jetë një prioritet me të cilën duhet të merren institucionet e Kosovës.

Por problematika kryesore është se krahas kësaj, me pasojat edhe më të mëdha paraqitet ndotja e ajrit, ku duhet të përmendet Termocentrali Kosova A si potencial i ndotjes enorme, duke mos lënë anash edhe kapacitetet e tjera. Në anën tjetër, kemi një gjendje ku pyjet janë shkatërruar në përmasa të mëdha, të cilës çështjeje nuk i është kushtuar rëndësi as në periudhën para luftës e sidomos asaj pas luftës, ku tranzicioni Kosovar ballafaqohet me probleme.

ASI: Cilat janë tri arritjet kryesore në fushën e mjedisit, në përmirësimin e mjedisit?

LZ: Gjithmonë, nëse paraqitet një problem, ai zë vend primar në krahasim me çka është punuar dhe arritur gjatë asaj kohe, kështu që institucionet dhe unë si çdo përgjegjës politik ballafaqohet me probleme të arsyetohet në debate siç ka qenë edhe konferenca rajonale parlamentare për çështjet mjedisore. Mirëpo, Kuvendi i Kosovës (KK) ka arritur, në partneritet me Qeverinë, të krijojë një legjislacion bazë që mundëson marrjen e hapave konkretë dhe krijimin e një mjedisit të favorshëm që kanë ndikuar drejtpërdrejt në parandalimin e ndotjes. Ne i dimë mundësitë aktuale të KK por nëse ne nuk kemi një



qasje shumë më koherente, praktike në bashkëpunim edhe me mekanizmat ndërkombëtarë në drejtim të fokusimit në një politikë shumë më aktive, atëherë nuk kemi qenë në nivelin e përgjegjësive si deputet dhe si qytetar.

ASI: Si e vlerësoni punën e Qeverisë në fushën e mjedisit?

LZ: Duke e marrë parasysh situatën alarmante aktuale, nuk e përmenda në detaje, por në këtë aspekt në periudhën e pasluftës është krijuar një bashkëpunim me segmentin ndërkombëtar, të cilët kanë sponsoruar ndërtimin e deponimeve për mbeturina, por tash për tash ballafaqohet me një sistem që është jashtë normave dhe standardeve ndërkombëtare, kemi fjalën për deponitë që sot janë aktuale e që nuk i plotësojnë standardet e parapara. Mirëpo në këtë drejtim ka mundur të arrihet më shumë, çka na bën të vlerësojmë se puna e Qeverisë në fushën e ruajtjes së mjedisit nuk ka qenë në nivelin e duhur.

ASI: A mund të emëroni tri prioritetet kryesore për 5 vitet e ardhshme në fushën e mjedisit?

LZ: Si prioritet kryesor duhet

të jetë zbatimi i ligjit për mbrojtjen nga ndotja e ajrit. Pra së pari duhet një qasje urgjente në monitorimin e kapaciteteve industriale të cilat janë jashtë çdo norme në fushë veprimtarinë e vet në aspektin mjedisor. Nën dy, Kosova duhet të ketë sistem për trajtimin e ujërave hedhurinë, që është një problem që kërkon një qasje shumë akute, trajtim të drejtpërdrejtë. Në anën tjetër, duhet të theksohet mungesa e ujërave, Kosova ka një mungesë të ujit të pijes, ku sidomos sivjet kemi qenë dëshmitarë se është dashur të ketë një qasje shumë më praktike. Unë jam i bindur se nëse kemi një politikë që do të mundësonte hapa konkretë në trajtimin e ujërave hedhurinë, atëherë do të kishim një gjendje shumë më relaksuese krahasuar me krejt mundësitë që mund të reflektohen prej këtyre ujërave në aspektin epidemiologjik dhe aspektet tjera shëndetësore. Nën tre, duhet të jetë trajtimi i ujërave industriale që janë akumuluar me vite të tërë dhe janë ndotës potencialë të ambientit, në veçanti të ujërave sipërfaqësore.

Intervistoi
Artan Canhasi,
Misioni i OSBE-së në Kosovë

Luftë ndërmjet njerëzve që dëshirojnë ta mbrojnë natyrën dhe sipërmarrjet ndërtimore

Intervistë me Petar Beron,

Anëtar i Komisionit Parlamentar për Mjedis dhe Ujëra i Kuvendit të Bullgarisë

ASI: Z. Beron, çka është ndryshuar në fushën e mjedisit gjatë pesë viteve të fundit në Bullgari?

Petar Beron: Në fillim të tranzicionit në vitin 1990, situata në Bullgari ka qenë ashtu siç është tani në Kosovë, me një shtrirje të gjerë të ndotjes, pa informata mbi parametrat të mjedisit, etj. Në fillim të karrierës sime si deputet i Kuvendit, para 17 viteve, gjithashtu isha i përfshirë në një OJQ të quajtur “Eko-glasnost”, e cila kishte punuar në ndryshimin e situatës së mjedisit. Para periudhës së pranimit, kur ne ishim kandidatë për BE, na është dashur ta harmonizojmë tërë legjislacionin me atë të BE-së. Si deputet, gjithashtu edhe si Zëvendës i Zëdhënësit të Parlamentit, sipas kërkesës së legjislacionit evropian, na është dashur që në Komisionin për Mjedis dhe Ujëra të miratojmë shumë ligje, madje disa prej tyre ende janë nën procedim. Ne duhet t’i harmonizojmë ato, meqë janë të obligueshme për ne, sepse kemi nënshkruar kartën në mënyrë që të merremi parasysh për pranim (në BE). Dje, në Kuvendin e Bullgarisë kemi miratuar Ligjin për dheun. Pas kornizës së përgjithshme, tani jemi duke miratuar ligje të veçanta për përbërës të ndryshëm të mjedisit. Gjithashtu kemi pasur një përmirësim në Ligjin për ndryshimet biologjike, pasi që tani është paraqitur lista e kafshëve të mbrojtura dhe ne duhet ta përfshijmë në ligj. Çështja kryesore pas pranimit në BE kishte qenë bashkimi në skemën “Natura 2000”. Natura 2000 është rrjeti i përgjithshëm për tërë Evropën. Ne ia kemi dërguar një listë BE-së të disa fushave të mbrojtura që do të

përfshihen në rrjet, një grup i ri i fushave në këtë kontekst. Nëse pajtohemi për këtë informatë, ne do të rrezikojmë të dënohemi nga BE-ja që nuk kemi bërë aq për projekte të ndryshme, d.m.th. kombëtare. Në listën më të re, më se 27% të territorit është e mbuluar me skemën Natura 2000. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse Bullgaria tani do të ketë fonde nga BE-ja për ngritjen e kësaj pjesëmarrjeje.

ASI: ne jemi të interesuar të dimë për obligimet që erdhën pas tranzicionit, çfarë kërkesash tjera keni?

PB: Një nga obligimet më të pafavorshme ishte mbyllja e reaktorëve të termocentraleve bërthamorë. Kjo ishte përfshirë në njerin nga kapitujt e Ujdisë për Pranim, për të cilën ne me të vërtetë kemi konsideruar që nuk ishte e drejtë, sepse këta reaktorë ishin plotësisht të sigurt, raporti i sigurisë ishte miratuar, ishte i menduar mirë dhe i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e BE-së dhe kishte pasur mënyra të shumta për t’i verifikuar këta reaktorë, që kishin dëshmuar se janë shumë të sigurt deri në skadimin e afatit të tyre në vitin 2012. Por, për arsye të presionit të shumë shteteve, Komisioni Evropian ishte dashur që të fus në njerin prej kapitujve të Ujdisë për Pranim se ne duhet t’i mbyllim katër reaktorët e parë, në fund të vitit 2006. Dhe mund të shihni se çfarë dëme i ka shkaktuar kjo ekonomisë së shteteve fqinje. Ne ishim eksportuesit kryesorë të energjisë elektrike, ku në vitin e kaluar kishim eksportuar 7 miliardë KW të gjitha shteteve që e rrethojnë Bullgarinë (Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë, Greqisë dhe Turqisë). Ne kemi mbuluar 80% të konsumit të



Petar Beron duke diskutuar në Konferencë

energjisë në rajon, por këtë vit eksportimi i energjisë elektrike kishte rënë në vetëm 1 miliardë KW dhe që nga viti i ardhshëm ne do të jemi ata që importojmë energjinë elektrike. Gjithashtu, ekziston edhe një problem tjetër. Me mbylljen e reaktorëve, burim kryesor të energjisë elektrike janë bërë termocentralët që shfrytëzojnë thëngjillin, që prapë e kanë ngritur një problem tjetër, atë të ndotjes, për shkak se e përdorin linjitin që përmban shumë sulfur. Tani ne jemi nën presion ose ta ndërrojmë linjën e prodhimit, ose ta mbyllim atë, për shkak se jemi të obliguar të zvogëlojmë rrezatimin. Kjo është duke u monitoruar. Ne e kemi një sistem të monitorimit të organizuar mirë. Nëse ky termocentral mbyllet, do ta vështirësojë edhe më shumë baraspeshimin e energjisë së vendit. Kështu, me ndihmën e qeverisë së Japonisë, duhet të përfundojmë ristrukturimin e këtyre termocentraleve, përdërisa në të njëjtën kohë jemi duke e ndërtuar një termocentral bërthamor tjetër, që ndoshta do të jetë gati në

vitin 2012. Kështu, ne presim që t’i tejkalojmë këto kriza për disa vite, por qëndrimi ynë ka qenë që këto termocentrale do duhej të punonin edhe pesë vitet e ardhshme. Është një pikë në këtë nen, i cili thotë që, nëse ka kriza rajonale në baraspeshimin e energjisë është e mundur që të fillojnë bisedimet për hapjen e sërishme të reaktorëve. Por, natyrisht, ka njerëz në Komisionin Evropian që e kundërshtojnë këtë, ata thonë që ne duhet t’i përmbahemi ujdive. Përndryshe, Bullgaria është duke u ballafaquar me probleme kundërtënëse ndërmjet ndryshimeve në zhvillim që ne i kemi. Tani ka një numër të ndërtesave të vjetra dhe ruajtja e mjediseve urbane është shumë e vështirë. Për shembull, restaurimi i qendrave malore të skijimit, vendeve bregdetare që për to bëhet një luftë ndërmjet njerëzve që dëshirojnë ta ruajnë natyrën dhe atyre që përkrahin zhvillimin.

ASI: Ju përmendët që Bullgaria do të ndërtojë një reaktor afër lumit Danub. Në këtë

Zbatimi i Ligjit për Mjedisin është prioritet në Kroaci

Intervistë me znj. Mirjana Brnadić,
anëtare e Komisionit Parlamentar për Mjedis të Kuvendit të Kroacisë.

kontekst, cilat janë sfidat kryesore të bashkëpunimit të kufijve në lëmin e mjedisit. Si ndihen fqinjët tuaj për këtë reaktor ose si ndihen ata në përgjithësi?

PB: këta reaktorë do të jenë absolutisht të sigurtë, sepse do të ndërtohen nga organet ndërkombëtare, kompanitë e huaja të cilat merren me këtë veprimtari për një kohë të gjatë. Sa i përket fqinjëve tanë, ta marrim shembull Rumaninë, ajo tenton të shes prodhimin nga termocentrali Cerna Voda, i cili po ashtu gjendet në Danub, kështu që ata do dëshironin që të na mënjanojnë nga tregu. Edhe Greqia ka disa ide për këtë, por nuk ka dyshim se kjo është mënyra e vetme për t'u siguruar energjia elektrike në Ballkan. Ne, gjithashtu, javën e kaluar kemi marrë pjesë në konferencën mbi ngrohjen globale të mbajtur në Bruksel. Ende nuk ka ndonjë vendim të qartë se a të zhvillohet, apo jo energjia bërthamore, dhe KE nuk do të ndërtojë në këtë. Por, në konferencë ne kemi thënë se energjia bërthamore është më e pastër, nuk ka radioaktivitet, dhe kështu ne duhet të ndërtojmë më shumë reaktorë. Burimet alternative të energjisë mund të jenë ide e mirë, por ato nuk mund të sjellin kontribute të vërteta në skemën energjetike. 75% të energjisë sonë vjen nga termocentralët që shkaktojnë ndotje, prandaj, nëse dëshirojmë të zvogëlojmë radioaktivitetin për 20%, që është vendim i KE, ne duhet me të vërtetë të shfrytëzojmë energjinë bërthamore.

Intervistoi,
Blerim Vela, Misioni i OSBE-së në
Kosovë



ASI: Cilat janë problemet kryesore mjedisore në Kroaci?

Mirjana Brnadić: Në Kroaci, besoj që është gjendje e ngjashme me problemet mjedisore edhe në vendet tjera në tranzicion, probleme këto me të cilat jemi duke u ballafaquar në 20-30 vitet e fundit. Që në fillim, ne kemi kuptuar se cilat janë sfidat tona, por është dashur t'i tejkalojmë ato hap pas hapi. Çështjet mjedisore janë gjithmonë të lidhura me çështjet ekonomike dhe aktualisht kemi arritur ta harmonizojmë, do të thosha, tërë legjislacionin tonë me atë të BE-së, si dhe kemi arritur përmirësime domethënëse në trajtimin e çështjeve mjedisore.

ASI: Cilët janë hapat që duhet marrë dhe si duket struktura negociuese në

fushën e mjedisit për sa i përket përafrimit të normave ligjore të BE-së?

MB: Që nga fillimi i negociatave mbi çështjet mjedisore, ne kemi harmonizuar legjislacionin dhe tani jemi në pritje të raportit të tretë të këtij Komisioni. Sipas të dy raporteve, kemi arritur rezultate të shkëlqyeshme, por duhet të bëjmë përmirësime në fuqizimin e administratës dhe çështje të caktuara të lidhura me mbrojtjen e ajrit.

ASI: Cili është roli i Parlamentit në këtë proces?

MB: Roli i Parlamentit është të miratojë ligje dhe t'i harmonizojë ato me ligjet e Bashkimit Evropian.

ASI: Çka duhet të bëjë një shtet për të fuqizuar mbrojtjen e mjedisit?

MB: Sfidat janë të mëdha, meqë rritja e standardit të një vendi, ekonomia më e zhvilluar, prodhimi më i madh, pa dyshim se rezultojnë me ndotje të mjedisit, ndërsa roli i shtetit është që të zvogëlojë këtë ndotje deri në kufij të lejuar dhe të fuqizojë pjesën administrative, e cila do të mund të monitoronte gjendjen e mjedisit dhe të zbatonte masa adekuate për të mbajtur mjedisin në kufij të lejuar.

ASI: Cilët janë prioritetet e Kroacisë në fushën e mjedisit për pesë vitet në vijim?

MB: Prioritetet mjedisore janë në veçanti zbatimi i këtyre ligjeve në jetën e përditshme, që nënkupton fuqizimin e sektorit administrativ, fuqizimin e heni-

meve dhe fuqizimin e fondeve të caktuara, të cilat janë të domosdoshme për t'u siguruar si dhe masat financiare për mbrojtjen e mjedisit. Gjatë pesë viteve në vijim, ne gjithsesi do të punojmë në zbatimin e strategjisë për menaxhimin e mjedisit, ku kemi identifikuar masa dhe programe, të cilat duhet të realizohen gjatë pesë viteve të ardhshme dhe shumëçka është duke u bërë në këtë drejtim. Ne tanimë kemi arritur rezultate të konsiderueshme, me të cilat mburremi shumë.

ASI: Çka mund të shtoni për fund?

MB: Është kënaqësi imja që jam në këtë konferencë, ku mund t'i dëgjoj praktikatat e të tjerëve, por gjithashtu mund të tregoj se çka kemi arritur ne, meqë mendoj se për sa i përket hyrjes në Bashkimin Evropian, ne në fakt i kemi realizuar shumicën e masave mbrojtëse për mjedisin dhe jam i bindur që përvojat tona mund të përdoren si instrumente edhe në Kosovë, meqë nga ajo që pashë me rastin e arritjes në aeroportin e Prishtinës, fatkeqësisht, ishte shumë mbeturina, shumë paketime, gjëra të cilat nuk ndodhin më në Kroaci. Unë ju ftoj të vini në Kroaci, në mënyrë që t'i shihni përvojat tona dhe fitoni ide mbi mënyrën se si e kemi trajtuar këtë problematikë, ashtu që edhe ju të përpiqeni t'i trajtoni këto probleme në të njëjtën mënyrë.

Intervistoi,
Lejla Selimi,
Misioni i OSBE-së në Kosovë

Prioriteti jonë është parku tej kufitar kombëtar Malet e Sharrit

Intervistë me Z. Marian Dodovski – ish Ministër i Mjedisit në Maqedoni,

aktualisht anëtar i Komisionit Parlamentar për Transport, Lidhje dhe Ekologji në Parlamentin e IRJ të Maqedonisë.



ASI: Ju lutem, a mund të na e përshkruani situatën e mjedisit në Maqedoni? Cili është rreziku më i madh i mjedisit?

Marian Dodovski: Gjendja e mjedisit në Maqedoni duhet të shikohet në një kontekst më të gjatë – atë rajonal, ashtu siç është gjendja e ngjashme në shtetet e Evropës Juglindore. Maqedonia e ka përballuar procesin e tranzicionit dhe në një periudhë të shkurtër e ka kaluar transformimin e pronës shoqërore në atë private. Tranzicioni i tillë ka ndikuar në mjedis.

Kur flitet në përgjithësi, Maqedonia është radhitur në mesin e shteteve që ka zona shumë të mbrojtura, përderisa në të njëjtën kohë ka edhe rajone që janë nën presion të jashtëzakonshëm nga ndotësit e ambientit. Ne kemi tre parqe nacionale: Pelister, Galicica dhe Mavrovo dhe rajone tjera të mbrojtura. Veç kësaj, në një të ardhme të afërt presim që

të përfshijmë Malet e Sharrit në kategorinë e parkut nacional, ndonëse dëshira jonë është që t'i shpallim Malet e Sharrit park nacional tej kufitar që bashkon rajonet e Maqedonisë, Kosovës dhe Shqipërisë.

Dikush mund t'i krahasoj pikat e nxehta të mjedisit me situatën e menaxhimit të mbeturinave. Maqedonia e ka vetëm një deponi, ajo gjendet afër Shkupit, kështu në të ardhmen duhet të bëhen më shumë përpjekje për të zgjedhur problemin e menaxhimit të hedhurinave. Megjithatë, mbetet një pyetje e hapur se a duhet të ndërtohen deponi rajonale, apo komunale. Pikat tjera të nxehta të mjedisit përfshijnë Shkrioren Veles, fabrikën Jugohrom në Tetovë, termocentralet në Oslomej dhe Manastir/Bitolë. Ia vlen të ceket se Maqedonia është duke u ballafaquar me problemin e stacioneve për trajtimin e ujërave e zeza, pasi që asnjë nga ujërat urbane apo të zeza të Shkupit, Tetovës, Gostivarit dhe qyteteve tjera nuk trajtohen para se ato të derdhen drejtpërdrejtë nëpër lumenj. Siç e përmenda më herët, gjendja e ambientit në Maqedoni ka dy anë të saja, natyrën e përsosur dhe disa presione të ndotjes së ambientit.

ASI: Çfarë mekanizmash janë krijuar për të mbrojtur natyrën dhe 'rajonet e mbrojtura'?

MD: Ne tani e kemi ligjin e ri për mbrojtjen e natyrës që përfshinë kategoritë e reja të rajoneve të mbrojtura dhe që është i bazuar në kriteret e vëna nga Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (UNMN/IUCN). Aktu-

alisht, Parlamenti ynë, sipas propozimit të Qeverisë është duke konfirmuar edhe një herë të gjitha rajonet e mbrojtura, aq më tepër, Parlamenti momentalisht është duke punuar në hartimin e ligjit të ri për parkun nacional Pelister duke përfshirë edhe kufijtë. Qeveria është duke punuar me përkushtim për t'i hartuar bazat e domosdoshme ligjore dhe për të përfshirë rajone të reja nën mbrojtje, me prioritet të lartë për t'i shpallur Malet e Sharrit si park nacional.

ASI: Cila është gjendja e legjislacionit maqedonas për mjedisin?

MD: Në fushën e legjislacionit për mjedis, Maqedonia ka arritur shumë - posaçërisht kur bëhet fjalë për përafrimin me legjislacionin e BE-së. Kemi ligje të reja të miratuara siç janë Ligji për Mjedis, Menaxhim të hedhurinave, Ndotjen me zhurmë, ligji për OGJM-të, të cilat janë përgatitur në bashkëpunim me programet e asistencës teknike të BE. Edhe pse Maqedonia i ka shumicën e ligjeve të domosdoshme, zbatimi i tyre akoma nuk është i mjaftueshëm. Maqedonisë i nevojiten instrumente ekonomike për të zgjedhur shumë probleme mjedisore.

Njëri nga ligjet e rëndësishme është ligji mbi ujërat i cili tanimë ka kaluar leximin e parë në Kuvend. Ligji i ri parasheh që ujërat duhet të menaxhohen dhe monitorohen vetëm nga një Ministri (Ministria e Mjedisit) në vend të praktikave të deritashme të shpërndarjes së përgjegjësisë në autoritete të ndryshme.

ASI: Ju si ish Ministër, dhe tani deputet, cili është vlerësimi juaj për ndërveprimin ndërmjet këtyre dy institucioneve në fushën e mbrojtjes së mjedisit?

MD: ka një bashkëpunim të mirë në fushën e mbrojtjes së mjedisit ndërmjet Ministrisë dhe Kuvendit. Sidoqoftë, Kuvendi duhet të jetë më ndikues, jo vetëm në fushën e harmonizimit të legjislacionit me normat e BE-së, por edhe në zbatimin e tij. Më tutje, degët ekzekutive dhe legjislative duhet të ngrisin ndërveprimin e tyre kur bëhet fjalë për bashkëpunim rajonal.

ASI: Cila është sfida më e madhe në bashkëpunimin tejkuftar në fushën e mjedisit?

MD: Dy vite më parë, kur unë shërbeja si Ministër i Mjedisit, ne ishim pjesë e iniciativës së themeluar rajonale për mjedis – Programi Rajonal për Rindërtim të Mjedisit (PRRM) për Evropën Juglindore si pjesë e Paktit të Stabilitetit. Kjo përfshinte instrumentet ekonomike, veprimet e shoqërisë civile, bashkëpunimin e ministrive të shteteve të rajonit, që kishin implementuar një numër projektesh, që kishin për qëllim zgjedhjen e problemeve mjedisore në rajon. Rëndësia e kësaj iniciative ishte e madhe pasi problemet mjedisore nuk njohin kufij shtetërorë, përkatësi etnike dhe fetare, kështu vetëm nëpërmjet komunikimit në nivel tejkuftar mund të flitet për këto probleme.

Brengat mjedisore në rajonin e Leposaviqit



Që nga 1972, Minierat e Trepçës në basenin e Kopaonikut (Belo brdo, Zhuta prla, Koporiq, Jelac dhe Gnjezhdan) janë duke e përqendruar xehen në Leposaviq në veri të Kosovës. Impianti i flotacionit si dhe deponitë e mbeturinave janë të vendosura afër qendrës së Leposaviqit. Para vitit 1972, procesi i ndarjes së gurit nga mineralet bëhej në impiantin e flotacionit në Zvečan. Pas thyerjes së xehes në pjesë përbërëse të imta, mineralet ndahen nga guri në një fuçi që përmban ujë dhe materie kimike, i ashtuquajtur proces i flotacionit. Kapaciteti i instaluar i impiantit për përpunimin e xehes në Leposaviq është 350.000 ton/vit.

Në mes viteve 1972 dhe 2006, sasia totale e xehes së përpunuar ishte 6.140.000 ton, që rezultoi me 249.580 ton koncentrat plumbi, 203.860 ton koncentrat zinku dhe 5.956.640 ton mbetje nga procesi.

Deponitë e mbeturinave

Janë dy deponi të mbeturinave të flotacionit, ku mblihdhet uji dhe llumi: një që nuk shfrytëzo-

het më në Gornji Krnjin dhe një tjetër që ende është funksional në Bostanishte. Të dy deponitë janë të vendosura në bregun e djathtë të lumit Ibër, afër rrugës rajonale Kraljevë - Prishtinë, në rajonin e Leposaviqit. Ato zënë sipërfaqe të mëdha të tokës kryesisht bujqësore dhe për arsye të përmbajtjes specifike të metaleve të rënda dhe materieve toksike që burojnë nga procesi i flotacionit, këto deponi janë burim për ndotjen e ajrit, sipërfaqes së tokës dhe ujërave nëntokësore. Pluhuri toksik në mbetje përçohet nga era, duke shkaktuar ndotje të gjerë në rajon. Nën ndikimin e shiut dhe borës, oksidet e metaleve të rënda, siç është plumbi, arseniku dhe zinku, mobilizohen dhe ndotin ekosistemet rrethuese, posaçërisht ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore të lumit Ibër. Si rezultat, uji nga lumi Ibër nuk është i përshtatshëm për konsum njerëzor, e as për qëllimi bujqësore.

Kjo ndotje nuk është vetëm problem lokal – një pjesë e ndotjes transportohet nga lumi

Ibër përmes lumit Moravë dhe Danub në Detin e Zi.

Metalet e rënda dhe shëndeti i njerëzve

Afërsisht 20.000 banorë jetojnë në pjesën më të madhe të hapësirës së Komunës të Leposaviqit. Zona qendrore, përfshirë këtu fshatrat Kutnje, Krushevë, Gornji Krnjin, Ulje, Tvrqjen dhe Kajkovo ka një popullatë prej 8.000 – 10.000 banorëve. Bujqësia është kryesisht e përqendruar përgjatë Ibrit dhe në zonat e larta. Të korrat më të zakonshme janë gruri, misri, fasulja, patatet, domatet, specat dhe qepët, përveç kultivimit të pemëve. Metalet e rënda siç janë plumbi, zinku, kadmiumi, arseniku, nikeli dhe merkuri janë duke u akumuluar në perime. Rrugët kryesore të ekspozimit të njerëzve ndaj ndikimeve të metaleve të rënda dhe komponentëve toksike janë thithja e pluhurit dhe konsumi i ushqimit (ujt nga burimet e ndotura, pemët, perimet dhe peshku nga lumi Ibër).

Në mes viteve 2004 dhe 2006, Fakulteti i Shkencave Teknike në Mitrovicë, në bashkëpunim me Institutin për Shëndetin e Njeriut dhe Fakultetin e Mjekësisë kanë hulumtuar ndikimin e mihjes në miniera dhe aktiviteteve metalurgjike në rajonin e Leposaviqit në mjedis. Hulumtimi i parë u përqendrua në prezencën e metaleve të rënda në tokë në territorin e Komunës së Leposaviqit, në anën veriore dhe jugore nga deponitë e mbeturinave dhe në kampin për refugjatët romë që është në qytet. Një nga konkludimet kryesore është se toka në rrethinën e Leposaviqit është shumë e ndotur dhe nuk është më e përshtatshme për qëllime bujqësore.

Në një fazë tjetër, u morën mostra gjaku nga 4 grupe të ndryshme me karakteristika të ngjashme epidemiologjike (I punonjës të Trepçës në profesione të ndryshme, të punësuar në industrinë e plumbit, II stafi mjekësor në Leposaviq, III fëmijë të moshës

< 6 nga kampi i romëve në Leposaviq, IV fëmijë të moshës < 6 nga çerdhja në Leposaviq).

Niveli i plumbit në gjakun e tyre u krahasua me standardet e OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë) për ekspozim profesional dhe joprofesional dhe me rekomandimin përkitazi me ekspozimin joprofesional të kategorive të ndjeshme të popullatës, siç janë fëmijët në grupet III dhe IV.

Në 66 përqind të mostrave, plumbi në gjakun e punonjësve të Trepçës e kalon kufirin KMP (Përqendrimi Maksimal i Pranueshëm) për ekspozim profesional. Për stafin shëndetësorë, rasti ishte i njëjtë në 17, 5 përqind të mostrave. 58 përqind e fëmijëve romë e kalojnë kufirin e KMP-së për ekspozim joprofesional, në krahasim me rezultatin prej 15,3 përqind për fëmijët në çerdhe. Mund të konkludojmë se ka një lidhje reciproke ndërmjet përqendrimit të plumbit në gjak dhe ekspozimin profesional ndaj plumbit. Dalimet në mes fëmijëve në grupin III dhe IV janë të rëndësishme dhe të shkaktuara nga shprehitja, higjiena dhe kushtet e këqija jetësore.

Duhet të ketë hulumtim apo studim të mëtejshëm dhe zhvillim të një plani për veprim, përfshi këtu një vlerësim të hollësishëm të situatës shëndetësore në Leposaviq/Leposavić.

Këtu duhet të përfshihet një fushatë për vetëdijësim të publikut, zhvillimin e një strategjie shëndetësore, identifikimin, definimin e të gjitha burimeve të ndotjes dhe propozimin e masave për eliminimin e tyre.

Nga Prof. Milan Barac, profesor në Fakultetin Teknik të Universitetit të Mitrovicës dhe bashkëthemelues i OJQ-së mjedisore "Zgjedhje Alternative" dhe Nikica Vitas asistent.

Sfidat në përmirësimin e qeverisjes mjedisore

Dr. Andrew Farmer, Instituti për Politika Mjedisore Evropiane, Londër



Qeverisja efektive mjedisore është e domosdoshme për të përbushur objektivat vendore si dhe ato ndërkombëtare. Megjithatë, janë edhe disa përfundime tjera që ndërlidhen me objektivat tjera të zhvillimit socio-politik. Mjedisi është një çështje e mirë përmes së cilës mund të nxitet debati dhe pjesëmarrja, jo vetëm duke u përqendruar në çështjet mjedisore që debatohen, por edhe duke ndihmuar në zhvillimin e praktikave pjesëmarrëse në mënyrë më të gjerë. Qeverisja efektive mjedisore mundëson komunitetet që të kuptojnë lidhjen e qartë në mes të çështjeve me rëndësi për ta dhe për rëndësinë e sundimit të ligjit. Rëndësia e pjesëmarrjes së avancuar nga ana e bartësve tjerë nuk duhet të nënvlerësohet, siç është krijimi i marrëdhënieve të reja në mes të industrisë dhe rregullatorëve, që mund të ndryshojë dinamikën e ndërveprimeve sociale dhe ekonomike. Përfundimisht, qeverisja efektive siguron një sistem formal për bashkëpunim ndërkombëtar, posaçërisht me fqinjët e parë, mbi çështjet tejkufitare, siç janë menaxhimi i ujërave.

Zbatimi di të jetë i vështirë për disa arsye. Qysh në vitin 1756, Benxhamin Franklin kishte thënë “Ligjet që janë shumë të butë rrallëherë respektohen; ligjet shumë të rreptë, rrallëherë ekzekutohen”. Është ky një koment akoma i vlefshëm në ditët e sotme. Mund të jenë një varg faktorësh që shkaktojnë probleme për zbatim. Kapaciteti i autoriteteve të zbatimit të ligjit mund të jetë joadekuat, p.sh. numri i pjesëtarëve të stafit, ekspertiza, pajisjet, etj. Kjo është posaçërisht e dukshme nëse autoritetet, papritur ballafaqohen me obligime të reja të imponuara në ta përmes legjislacionit të ri. Mund të ketë kufizime në instrumente ligjore, p.sh. gjokat apo ndëshkimet tjera mund të mos jenë të mjaftueshme për të ndryshuar sjelljen. Mund të ketë kundërshtime politike, p.sh. ligji mjedisor mund të kërkojë mbylljen e një fabrike, por kjo kundërshtohet nga komuniteti vendor.

Është me rëndësi që të gjendet bilanci i duhur në mes të objektivave. Së pari, duhet të parashtrihen kërkesat kryesore për mbrojtje mjedisore dhe të shëndetit (lejimi i vazhdimit të derdhjeve toksike që dëmtojnë shëndetin nuk është e justifikueshme). Veç kësaj, ligjet duhet të marrin parasysh çështjet e zbatimit në praktikë, p.sh. funksionet dhe kapacitetet institucionale. Është e pakuptimtë që nga autoritetet të kërkohej ndërmarrja e aktiviteteve që janë të pamundura për ta. Prandaj, është me rëndësi që të caktohet bilanci në mes të fleksibilitetit dhe udhëzimit në ligj. Fleksibiliteti mund të lejon identifikimin e së paku qasjeve të kostos, por edhe mund të jetë burim intensiv për implementim. Udhëzimi mund të caktojë

kërkesa në ‘gurë’, mirëpo mund të ketë rrugë më të lehta që mund të merren. Përfundimisht, përcaktimi i afateve është po aq i rëndësishëm, d.m.th. qasja në ligj mund të jetë e saktë, por çështjet e zbatimit në praktikë kërkojnë përkujdesje në përcaktimin e orarit për implementim.

Pasi që të jenë shqyrtuar këto çështje, është edhe më me rëndësi që ligjet të shkruhen në një mënyrë e cila mundëson implementim efektiv dhe i lejon qeveritë që të përdorin ligjet në mënyrë efektive. Disa elemente të domosdoshme për të siguruar këtë janë:

- Të ketë definicion të qartë ligjor të objektivit.
- Është me rëndësi që të definohen qartë ato që rregullohen dhe obligimet mbi to.
- Obligimet në ligj duhet të jenë të arritshme.
- Obligimet duhet të komunikohen në mënyrë efektive në opinionin publik dhe te ata ndaj të cilëve aplikohet ligji.
- Ndëshkimet duhet të vendosen në atë mënyrë që pajtueshmëria të shihet si më përfituese sesa të shkelej ligji.
- Përtej përdorimit të ndëshkimeve, mënyrave e shmangies së sjelljes së papajtueshmërisë duhet të zvogëlohen.
- Është me rëndësi që qartë të definohen opsionet për veprim të zbatimit.

Realizimi i parimeve është sfidë. Duhet të ketë analiza efikase të çështjeve të cilat shqyrtohen (mjedisore, ekonomike, institucionale, etj.), debate të mjaftueshme me bartësit (industria, qytetarët, etj) dhe

bashkëpunim adekuat në mes të zyrtarëve dhe parlamentarëve. Është po ashtu me rëndësi të ketë kohë dhe resurse të mjaftueshme për të mundësuar këtë gjë. Qytetarët janë partnerë kyç në proces. Shumë ligje mjedisore të BE-së kanë theksuar përfshirjen e bartësve, p.sh. lejimet e KIPN-së apo planifikimi i menaxhimit të brigjeve të lumenjve, dhe bartësit mund të ofrojnë inupte të vlefshme në ligjëbërje. Komunikimi do të zmadhojë mirëkuptimin e obligimeve ligjor, prandaj, ato do të bëhen më efektive.

Parlamentet luajnë një rol kyç në procesin e zgjerimit të BE-së. Megjithatë, probleme mund të ngrihen nëse parlamentarët kërkojnë që të ‘miratojnë pa menduar’ kërkesat e BE-së. Në anën tjetër, shumë obligime të BE-së kërkojnë shprehjen e kushteve kombëtare/vendore, përfshirë kontekstin ligjor dhe kjo është një mundësi e rëndësishme për angazhim parlamentar. Parlamentarët duhet që të sigurojnë se ligjet (nga fillimi deri në fund) janë të përdorshme dhe të zbatueshme, si dhe, gjatë transpozimit të ligjit të BE-së, Parlamentarët mund të kërkojnë avancimin e integritimit me ligje dhe politika tjera (përfshirë në nivel kombëtar), siç janë objektivat pjesëmarrëse.

Në përmbllje, është me rëndësi që të kemi legjislacion efektiv mjedisor si pjesë e zhvillimit më të gjerë politik/social. Është një sfidë të madhe që ligjet mjedisore të jenë edhe ambicioze edhe të arritshme. Parlamentarët luajnë një kontribut të rëndësishëm këtu përmes analizimit të ligjeve – jo vetëm obligimet e tyre bazike, por duke konsideruar zbatueshmërinë e tyre të plotë dhe rolin e pjesëmarrjes së qytetarëve.

Dimensioni mjedisor i procesit të hyrjes në BE

Nga Dr. Kerstin Tews, këshilltare e politikave dhe bashkëpunëtore hulumtuese në Qendrën për Hulumtime të Politikave Mjedisore në Freie



Me krijimin e Procesit të Stabilizim Asociimit në vitin 1999, Bashkimi Evropian (BE) u ka ofruar vendeve të Evropës Juglindore (EJL) perspektivën e bërjes shtete anëtarë në një periudhë afatmesme ose afatgjatë. Si çdo vend që kërkon të bëhet anëtar, vendet e rajonit të EJL-it duhet të jenë plotësisht në përputhje me rregullat e BE-së. Meqë kriteret e Kopenhagës, të miratuara në vitin 1993, përcaktojnë që një shtet i ri anëtar duhet t'i përmbushë tri kriteret:

- politik: stabiliteti i institucioneve të cilat garantojnë demokraci, sundim të ligjit, të drejta të njeriut, respektim dhe mbrojtje të pakicave;
- ekonomik: ekzistimin e një ekonomie funksionale të tregut dhe kapacitetin për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forca të tregut në kuadër të Bashkimit;
- pranimi i kuadrit ligjor të Bashkimit Evropian; aftësia për të marrë përsipër obligimet e anëtarësimit, duke përfshirë veprimin në përputhje me synimet e një bashkimi politik, ekonomik dhe monetar.

Cjersa kriteret politike dhe ekonomike pasqyrojnë parimet themelore të demokracisë dhe të ekonomisë së tregut si parime udhëzuese të integritimit evropian, kriteri i tretë është më shumë së një kornizë bazike për një rend shoqëror të dëshiruar. Acquis communautaire (legjislacioni i BE-së) përbëhet nga një sasi e madhe e akteve ligjore të fushave të ndryshme të politikave, duke përfshirë edhe mjedisin, të zhvilluara me dekada, gjë që janë të detyrueshme për shtetet anëtare dhe ato të cilat dëshirojnë të bëhen anëtarë para hyrjes së tyre.

Sfida nga perspektiva e BE-së

Suksesi ose dështimi nga ana e BE-së në përgatitjen e anëtarëve të rinj potencial ka patur gjithsesi ndikim në kapacitetin e ardhshëm të BE-së për të vepruar. Kjo ka qenë e vërtetë që nga fillimi i procesit të zgjerimit, por nuk është shprehur aq qartë në dokumentet e mëparshme zyrtare se në Strategjinë e re të Zgjerimit të miratuar në vitin 2005 (COM (2005) 561 final).

Strategjia e re e Zgjerimit përcakton tri

parime kryesore:

1. Konsolidimi i zotimeve (d.m.th. veprimi në përputhje me zotimet e bëra dhe kujdesi ndaj dhënies së zotimeve të reja);
2. Kushtëzimi i rigoroz dhe i drejtë;
3. Komunikimi

Parimi 1 i referohet vlerësimit se ritmi i zgjerimit duhet të marrë parasysh kapacitetin absorbues të BE-së. BE-ja ka nevojë të sigurohet që kapaciteti i saj të jetë funksional, gjatë zgjerimit të saj. Kjo kërkon reforma institucionale sa i përket procesit të vendim-marrjes në kuadër të BE-së, kapacitet që të hartohen politika të mëtejshme inovative, në rast zgjerimi dhe shqyrtim të kufizimeve buxhetore.

Një nga instrumentet kryesore dhe të reja të strategjisë së zgjerimit i referohet kapacitetit të përpilimit të politikave në rast të zgjerimit: Është një lloj vlerësimi i ndikimit të hyrjes potenciale të vendit në kapacitetin e BE-së për të vepruar. Strategjia e zgjerimit 2006-2007 e cek qartë se çdo mendim i Komisionit sa i përket

aplikimit të një vendi për anëtarësim tani do të përfshijë edhe vlerësimin e ndikimit të hyrjes së atij vendi në politikën e BE-së. Kjo nënkupton që BE-ja është gjithnjë e më rigorozë gjatë vlerësimit të përbushjes së kriterëve për anëtarësim. Komisioni thekson “Zgjerimet e mëtejme do të shkojnë sipas ritmit të diktuar nga performanca e secilit vend në përbushjen e standardeve rigorozë, për të siguruar absorbim të lehtë dhe të papenguar të anëtarëve të rinj” (COM 2005 561 final: 4). Kjo do të thotë se zgjerimi i mëtejme nuk do të përfshijë, si në të kaluarën, një grup më të madh të vendeve.

Parimi 2 është drejtpërdrejt i lidhur me atë të parin: Zbatimi i kushtëzimit të drejtë dhe rigoroz është njëra nga shtyllat e strategjisë së re të zgjerimit. Kushtëzimi thjesht do të thotë: pa përbushjen e obligimeve për anëtarësim nuk është e mundur asnjë hyrje. Këto standarde janë kriterë të matshme dhe u referohen elementeve kyçe të një kapitulli të legjislacionit të BE-së (acquis). Shkurt me të nënkuptohet: Hapja e kapitullit për negociatën varet nga përbushja e standardeve të hapjes. Standardet e përcaktues kanë të bëjnë me masat legjislative, institucionet dhe organet administrative dhe një evidentim i qartë i zbatimit të legjislacionit të BE-së (COM (2006) 649:6).

Kjo është në përputhje të plotë me deklaratën e Komisionit në vitin 1998 lidhur me strategjitë e zgjerimit për mjedisin sa i përket vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL):

“Përbushja e kuadrit ligjor të BE-së nuk është qëllimi përfundimtar, as për vendet candidate, e as për Bashkimin Evropian. Sfidat e integritetit të plotë të zhvillimit të qëndrueshëm të dimensionit mjedisor në të gjitha fushat kryesore mbetet një sfidë e madhe dhe urgjente për tërë Bashkimin Evropian. Procesi i zgjerimit duhet të shihet në perspektivë më të gjërë dhe duhet të menaxhohet në atë mënyrë që objektivi i zhvillimit vërtet të

qëndrueshëm të sjellet më afër shtëpisë” (COM 1998)294: 19).

Përbushja e rregullave ekzistuese të legjislacionit të BE-së për mjedisin – i cili gjithmonë është rezultat i kompromisit ndërmjet prijesve në aspektin mjedisorë dhe të prapambeturve në BE. Prandaj është minimum që BE-ja së paku duhet të kërkojë me qëllim që të sigurojë kapacitetin e BE-së që të zhvillojë më tej politikën mjedisore pas zgjerimit.

Parimi i tretë i referohet nevojës për të përfshirë publikun në një shkallë më të madhe – jo vetëm në vendet për hyrje, por po ashtu edhe në shtetet anëtare. Kjo pasqyrohet atë që suksesi i zgjerimeve të tjera varet nga përkrahja e publikut dhe një legjitimim më të madh demokratik të procesit të zgjerimit.

Sfida nga perspektiva e vendeve të EJL-së

Si vendet e EQL-së, vendet e EJL-së ballafaqohen me sfidat e shoqërive në transicion: që në të njëjtën kohë të zhvillojnë struktura demokratike dhe të fusin në përdorim parimet e ekonomisë së tregut. Për të dyja rajonet, kjo detyrë e ristrukturimit është/ishte kornizuar pothuajse që nga vetë fillimi i transicionit nga opsioni i bërjes anëtarë të BE-së.

Kështu që, rindërtimi i rendit shoqëror në rajonin EQL-së ishte më së fundi pas nënshkrimit të marrëveshjeve të asociimit në mesin e viteve të 1990-ta në një shkallë të madhe të përshtatur nga rregullat ligjore nga jashtë. Me nënshkrimin e Partneriteteve Evropiane në kuadër të Procesit të Asociimit dhe të Stabilizimit kjo u bë relevante për tërë procesin e ristrukturimit edhe në vendet e rajonit të EJL-së – megjithëse gjendja është edhe më sfiduese për shkak të divergjencave mbizotëruese që rrjedhin nga trashëgimia e pasluftës dhe e konflikteve etnike. Sidoqoftë, qëllimi i përbashkët i anëtarësimit në BE mund të jetë një pikë e qasjes për trajtimin e këtyre divergjencave sikur të gjitha vendet që ballafaqohen me një sfidë të ngjashme.

Veprimi në përputhje me kuadrin ligjor të BE-së është parakusht themelor për hyrje. Së pari kjo kërkon, bartjen e akteve ligjore në legjislacionin kombëtar dhe e dyta, implementimin dhe vënien në zbatim në nivel kombëtar të vendeve candidate.

Legjislacioni i BE-së për mjedisin është vetëm një pjesë e tërësisë së legjislacionit të BE-së, por meqë është zhvilluar që nga vitet e 1970-ta ajo përmban një numër shumë të madh të akteve ligjore – më shumë se 200 akte legjislative, të cilat pasqyrojnë zhvillimin e politikave në lidhje me çështjet mjedisore në BE.

Për vendet e EJL-së, obligimi për t'i përbushur kriteret mjedisore për hyrje ofrojnë mundësi që të zhvillohen politika mjedisore në rrethana shoqërore të një vendi në transicion, ku pa opsionin e anëtarësimit çështjet mjedisore vështirë se do të hynin në agjendën politike. Çështjet e tjera si ristrukturimi ekonomik, vështirësitë shoqërore, konsolidimi politik dhe – në rast të këtij rajoni – trashëgimia e luftërave dhe konfliktet etnike do të zhvendosnin mjedisin nga agjenda. Kështu që, nga kjo perspektivë, kushtëzimi dhe vendosja nga jashtë e agjendës lidhur me legjislacionin mjedisor të BE-së ofron mundësi që të mos harrohen çështjet mjedisore dhe të krijohen kapacitetet e nevojshme institucionale, ligjore dhe njerëzore.

Megjithatë, ky proces i përcaktimit nga jashtë të agjendës lidhur me zhvillimin e politikave mjedisore po ashtu nënkupton edhe disa pyetje shumë të rëndësishme jo vetëm për rajonin tuaj, por edhe për kapacitetin e BE-së që të zhvillojë më tej politikën mjedisore.

(Fragment nga punimi i përgatitur për Konferencën Rajonale Parlamentare mbi Mjedisin 'Mjedisi është një medium ku promovohet demokracia dhe zhvillimi ekonomik i shoqërive në transicion', 17 – 20 tetor 2007 në Prishtinë).

Modeli i Qendrës Aarhus



Organization for Security and Co-operation in Europe

THE AARHUS CENTRE MODEL

Supporting people's rights
in environmental matters

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) është duke përkrahur të drejtat e njeriut në çështjet mjedisore, duke ndërtuar ura lidhëse në mes të qytetarëve dhe qeverive përmes qasjes në informatat, që janë pjesë e vendimmarrjes dhe qasjes në drejtësi

OSBE-ja dhe Konventa Aarhus

Që nga viti 1999, OSBE-ja ka promovuar ratifikimin dhe zbatimin e Konventës Aarhus nga ana e shteteve të saj anëtare, duke organizuar kampanja të ngritjes së vetëdijes, seminare kombëtare dhe rajonale, si dhe duke përkrahur themelimin, regjistrimin dhe veprimin e OJQ-ve mjedisore.

Që nga viti 2002, Zyra e Koordinatorit për Aktivitete ekonomike dhe mjedisore pranë OSBE-së dhe zyrat në terren të OSBE-së kanë përkrahur zhvillimin e Qendrave Aarhus në Kaukaz, Azinë Qendrore dhe Evropën Lindore. Qendrat, përveç që plotësojnë institucionet ekzistuese zyr-

tare, ato synojnë të jenë më të qasshme për përdoruesit. Qendrat mund të drejtohen nga qeveritë apo OJQ-të, apo të jenë të mëvetësishme. Të tri llojet e organizimeve janë duke u përdorur aktualisht, varësisht nga preferencat dhe kushtet lokale. Në të gjitha rastet, themelimi i Qendrave bazohet në marrëveshje në mes të OSBE-së dhe Ministrisë së Mjedisit. Përfshirja e OJQ-ve në menaxhimin e veprimeve të Qendrave, sigurohet përmes përbërjes së balancuar të bordit menaxhues, i cili duhet të jetë i përbërë nga një numër i barabartë i përfaqësuesve të qeverisë dhe shoqërisë civile. Roli i Qendrës Aarhus është që të ofrojë një vendtakim dhe lidhje në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile. Është e rëndësishme, që Qendrat nuk janë vetëm objekte me rafte të pluhurosura të librave, por janë dinamike, inovative dhe të angazhuara që në mënyrë aktive t'i qasen qytetarëve.

Shembuj të aktiviteteve të Qendrës Aarhus

- Sigurimi i qasjes së lehtë

në informata mjedisore për opinion publik dhe vendimmarrësit.

- Ripaketimi i informatave mjedisore në një format më të kapshëm dhe më joshës për përdoruesit.
- Angazhimi i qeverisë dhe shoqërisë civile në dialog dhe këmbim të informatave.
- Ngritja e vetëdijes së publikut mbi çështjet mjedisore përmes organizimit të takimeve dhe seminareve të temave të ndryshme, si dhe përmes masave tjera.
- Promovimi i pjesëmarrjes në vendimmarrjen mjedisore përmes organizimit të dëgjimeve publike mbi projektligje.
- Organizimi i trajnimeve për gazetarë, pjesëtarë të personelit gjyqësor, nxënës dhe grupe tjera të caktuar.
- Ofrimi i këshillave ligjore për qytetarët dhe organizatat në lidhje me çështjet mjedisore.

Mjedisi, Siguria dhe Aarhus Përmes Iniciativës për Mjedis dhe Siguri (EnvSec) (www.envsec.org), OSBE-ja, në partneritet me UNEP, UNDP dhe NATO, ka identifikuar një varg “pikash të nxehta”, ku çështjet mjedisore në kombinimin me faktorët themelorë socio-ekonomikë dhe politikë, janë burime të mundshme të konfliktit. Iniciativa EnvSec është duke përkrahur krijimin e Qendrave lokale Aarhus/të Informimit Mjedisor në këto lëmi të ndjeshme. Në këtë mënyrë, Qendrat shërbejnë si forum për ndarje të mendimeve dhe qartësimin e fakteve para se ato të ngrihen në situatë me potencial eksploziv. Me mbështetjen e Qendrës Aarhus mund të diskutohen shqetësimet e komunitetit dhe këto t'i komunikohen vendimmarrësve, duke ia mundësuar vendorëve që t'i shprehin drujtjet dhe frustrimet e tyre. Veç kësaj, njerëzit mund të këshillohen mbi mënyrën se si ata vetë mund të mbrojnë dhe përmirësojnë mjedisin e tyre, në lidhje me nxitësit potencialë të konfliktit.

Shoqëria civile mjedisore në Kosovë dhe sfidat mjedisore para saj



Në Kosovë, koncepti i përgjithshëm i shoqërisë civile është relativisht i ri, ndërsa shoqëria civile mjedisore është akoma më e re. Para vitit 1999, si shoqëri civile mjedisore ka funksionuar Lëvizja e të Gjël-bërve, që në ato kushte nuk ka mundur të ketë ndonjë efekt të dukshëm në shoqëri.

Një evoluim në zhvillimin e shoqërisë civile mjedisore ndodhi pas luftës së fundit në Kosovë. U themeluan OJQ të shumta, të cilat falë donacioneve që gjatë periudhës 2000-2002 ishin të dukshme, zhvilluan projekte të ndryshme. Mund të konkludohet se shumë OJQ janë themeluar pikërisht me grantet e donatorëve në formë projektesh, e tek më pas janë zhvilluar në OJQ të mirëfillta. Megjithatë shumica e projekteve ishin të vogla dhe pa ndonjë ndikim të dukshëm në përmirësimin e problemeve të akumuluarara me dekada të tëra, gjë që ishte edhe në raport normal me kapacitetet e këtyre organizatave.

Një punë e madhe është bërë në ngritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile mjedisore sidomos me themelimin të REC-ut në Kosovë, si një organizatë ndërkom-bëtare me mision "organizimin dhe rior-ganizimin e shoqërisë civile mjedisore në Kosovë". Trajnime të shumta u bënë udhërrëfyes për organizatat se si duhet të organizohen dhe t'ju qasen zgjidhjes së problemeve, cilat mjete dhe metoda duhet

t'i përdorin, si duhet të llobojnë dhe avokojnë, si duhet të përgatiten për udhëheqjen e fushatave mjedisore etj.

Sipas hulumtimeve më të fundit të bëra në vitin 2006, në Kosovë janë rreth 30 organizata aktive në fushën e mjedisit që kanë një anëtarësi të përgjithshme prej 2878 njerëzish (përfshirë stafin e rregullt dhe vullnetar) të shtrira në rreth gjysmën e komunave të Kosovës. Fushat më të preferuara të punës së këtyre organizatave janë në projektet e: fushatave për ngritjen e vetëdijes për mjedisit, edukimit mjedisor si dhe organizimi i seminareve, konferencave e debateve për problemet mjedisore.

Sfidat me të cilat u ballafaqua shoqëria civile mjedisore ishin dhe janë të shumta: gjendja e rëndë ekonomike në përgjithësi dhe ajo mjedisore në veçanti, kapacitetet e kufizuara njerëzore për tu ballafuar me probleme, ekspertiza e kufizuar e anëtarëve. Një problem në vete ka paraqit vetë prioritizimi shumë i ultë i mjedisit si problem nga ana e institucioneve qeveritare, që ka reflektuar edhe në mungesën e interesit të donatorëve për ta mbështetur më fuqishëm sektorin e mjedisit, nga e cila mbështetje sigurisht se direkt ose indirekt do përfitonin edhe OJQ-të mjedisore. Megjithatë vlen të lavdërohet dhe falënderohet mbështetja për sektorin e mjedisit në përgjithësi dhe për shoqërinë civile mjedisore në veçanti nga ana e donatorëve liderë në fushën e mjedisit. Agjencia Evropiane për Rindërtim, Qeveria Suedeze përmes Sidas, KFOS, Qeveria Holandeze etj. Ministria përkatëse e mjedisit, me problemet strukturore dhe buxhetin shumë të limituar, deri tani përveç përkrahjes morale dhe bashkëpunimit në parim (sidomos në kampanjën e njohur Kosova-shtëpia ime), nuk ka pasur forma të tjera të mbështetjes për OJQ-të mjedisore.

Tashmë shoqëria civile ka zhvilluar kapacitete të mjaftueshme që të fillojë edhe formimin e rrjeteve me qëllim të përforcimit të rolit në menaxhimin e përgjith-

shëm të çështjeve mjedisore. Një e arritur e konsiderueshme në këtë aspekt është formimi i SharriNet, një rrjetë elektronike e organizatave mjedisore, që me gjithë problemet ekzistuese po bën një punë të lakmueshme në avokimin e shoqërisë civile. Hapja e Forumit elektronik mjedisor, si një vend ku ambientalistët mund t'i shfaqin shqetësimet e veta është një nga aktivitetet e fundit.

REC-Zyra në Kosovë, që nga themelimi ka mbështetur shoqërinë civile mjedisore me qëllim të fuqizimit dhe shndërrimit të saj në një aktor të rëndësishëm në zgjidhjen e problemeve mjedisore. Janë me qindra trajnimet, punëtoritë, vizitat studimore për shkëmbime përvojash që janë organizuar në këtë kohë. Janë një numër prej rreth 40 OJQ-sh mjedisore, por edhe institucion komunale e shkolla që kanë përfituruar grante në kuadër të programeve dhe projekteve të REC-ut në Kosovë. Kjo do të jetë strategji udhëheqëse e REC-ut edhe në vazhdim.

Aktualisht, REC është duke ndihmuar procesin e vendosjes së një mekanizmi formal partneriteti në mes shoqërisë civile mjedisore në një anë dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në anën tjetër. Ky proces do përfundojë me adoptimin e Strategjisë për Bashkëpunim, që pritet të bëhet së shpejti nga grupi punues i përbërë nga shoqëria civile dhe Ministria. Po punohet edhe në forcimin e mëtuqjeshëm të kapaciteteve të OJQ-ve mjedisore (sidomos atyre të krijuara më vonë) përmes programeve të trajnimit, por edhe të mbështetjes direkte përmes komponentëve të granteve në kuadër të disa projekteve ekzistuese. Sfidat janë gjithnjë e më të mëdha: eliminimi i ndotjes nga e kaluara, zhvillim ekonomik, investimet e mëdha, e në këtë drejtim duhet të orientohet edhe organizimi i shoqërisë civile

Dr.sc. Zeqir Veselaj, drejtor, Qendra Rajonale e Mjedisit- Zyra në Kosovë

Regional Environmental Center REC-Office in Kosovo

Qytetarët të pakënaqur me gjendjen e mjedisit

“Politika mjedisore ka. Ka ligje që të gjitha thirren në parimet dhe standardet e Bashkimit Evropian. Por implementimi është shumë i ulët. Ky mosimplementim fillon nga vet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e përfundon te qytetari i thjeshtë”, tha Zeqir Veselaj, drejtor i Qendrës Rajonale për Mjedis (REC)



Ndryshimet klimatike të cilat kanë përshkuar çdo cep të globit kanë shtyrë llupën e njeriut të fokusojë mjedisin. Rreziku ka rikthyer mjedisin në vendin e duhur. Tashmë mjedisi është pjesë e marrëveshjeve ndërshtetërore dhe bazë e politikave partiake e ndërkombëtare por shtrohet pyetja cila është gjendja e mjedisit në vendin tonë? Cilat janë problemet kyçe mjedisore dhe a ka të ardhme evropiane mjedisore Kosova?

Sipas Zeqir Veselajt drejtor i Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) gjendja e mjedisit në vendin tonë nuk është e mirë. Uji, ajri dhe mbeturinat janë tri fushat të cilat sot janë të ndikuara nga faktori njeri dhe anasjelltas ato ndikojnë në vet organizimin e njeriut. Sot në

Kosovë ende nuk ka trajtim të duhur të ujërave të zeza madje nuk ka as matje të rregullta të puseve të ujërave të pijshëm. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) me tyntarët e tij të pakontrolluar dhe makinat e vjetërsuara janë ndotësit e ajrit dhe mbeturinat të cilat ende i gjen në rrugët e Kosovës. Për të gjitha këto përgjegjës sipas Veselajt janë institucionet por edhe qytetari. “Padyshim se fajin për një gjendje të këtillë e bartim të gjithë që prej qytetarit e deri te instancat më të larta të qeverisjes: ministria dhe pushteti lokal. Edhe qytetari është fajtor sigurisht” tha Veselaj. Por krahas gjendjes momentale mjedisore a ekzistojnë rrugët që të bëhet më shumë, a ka politika të duhura mjedisore institucionale në Kosovë? Sipas Veselajt të

gjitha këto ekzistojnë në vendin tonë me përjashtim të dëshirës për veprim pra implementim. “Politika ka. Ka ligje që të gjitha thirren në parimet dhe standardet e BE-së. Por implementimi është shumë i ulët. Ky mosimplementim fillon nga vet MMPH e përfundon te qytetari i thjeshtë”, tha Veselaj duke shtuar se ekziston edhe strategjia mjedisore e aprovuar në vitin 2004 për periudhë 10 vjeçare por e cila nga vet kjo ministri nuk është marrë asnjëherë seriozisht.

Së bashku me Strategjinë për Mjedis ekziston edhe Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis e i cili është harruar. Këto janë disa fakte të cilat krahasojnë skajshmërisht botëkuptimin mjedisorë

evropian dhe atë Kosovare.

Bashkësia Evropiane ka një varg të gjatë të kërkesave të cilat janë dhe do mbesin çelësi i çdo shteti që ka mbetur jashtë saj. Ato duhet të implementohen. “Vetëm keni parasysh se vetëm kërkesa e Acquis Communautaire për mjedisin kërkojnë implementimin e rreth 300 akteve ligjore të BE-së në mënyrë që më pas të trokasësh në derën e BE-së dhe nuk ta hapin pa i përmbushur (mund të bëhen disa tolerime kohore por assesi pa i përmbushur). Këto janë kryesore por pastaj vijnë në rend edhe kërkesa e konventave ndërkombëtare mjedisore (si Protokollin e Kjotos)” tha Veselaj.

Edhe Vegim Kraja, qytetar i Prishtinës mendon se Kosova përkundër aktiviteteve të vogla prodhuese është një vend i ndotur. Ai cek shkaqet që sipas ti kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në ndotjen e mjedisit. Së pari automjetet e vjetërsuara në numër të madh të cilat janë futur në mënyrë të pakontrolluar pas vitit 1999. Së dyti teknologjia e vjetërsuar e cila përdoret në Kosovë, për prodhimin e rrymës elektrike, e cila nuk është rinovuar në pajtim me standardet evropiane. Së treti hapësirat e gjelbëruara të cilat janë duke u shkatërruar në kontinuitet, sidomos në hapësira urbane, mungesa e kujdesit për pyjet dhe investimet e pakta në pyje. Së katërti mungesa e një legjislacioni adekuat për mbrojtjen e mjedisit dhe mungesa e bashkëpunimit me mekanizmat ndërkombëtare dhe regionalë.

Kraja shprehet kritik ndaj mungesës së lobimit të fuqishëm nga shoqëria civile për çështje mjedisore. E tillë është edhe mungesa e një partie të fortë me orientim të gjelbërt. Kraja mendon se edukimi është i mangët i qytetarëve sa i përket mbrojtjes së ambientit dhe rreziqeve lidhur me ndotjen e ambientit. Kraja shpreh shqetësimin nga radioaktiviteti eventual i bombave të NATO- s gjatë kampanjës së bombardimeve gjatë luftës së 1999. Sipas Krajës Prishtina konsiderohet rajoni më i ndotur për shkak të afërsisë që ka me termocentralet dhe ngrohtores e cila gjendet brenda zonave të banuara. “Së pari, duhet të adaptohet një legjislacion në pajtim me të drejtën evropiane për mjedisin dhe së dyti, të ndërmerret një fushatë edukuese e cila sensibilizon qytetarët për rrezikun nga mjedisi i ndotur” janë dy vijat që sipas Krajës do ishin armë për të luftuar shkatërrimin e mjedisit në vendin tonë.

Se Kosova ka një mjedis të ndotur mendon edhe qytetari Vehbi Dugolli i cili jeton afër sheshit “Zahir Pajaziti”. Sipas tij fajtorët kryesorë për këtë gjendje mjedisore janë institucionet “Unë kamë shëtitur shumë vende të botës secili vend është shumë më i rregulluar se vendi ynë, mirëpo te ne fajin e kanë institucionet” tha Dugolli. Ahmet Pllana një qytetar tjetër fajëson kompanitë publike që nuk po e kryejnë punën si duhet dhe njëherësh edhe vet qytetarin e Kosovës i cili nuk ka vetëdije të lartë për mjedisin dhe pastërtinë. “Kompanitë publike të cilat janë për

pastrim nuk e kryejnë punën ashtu siç duhet mirëpo mungon edhe vetëdija e qytetarëve për të qenë i pastër dhe kjo vetëdije mund të arrihet vetëm duke parë qytetet e Evropës përndryshe Kosova nuk mund të jetë e pastër”, tha Pllana.

Në anën tjetër Sahit Kelmendi mendon se vendi ku jeton nëse do bëhej një listë krahasuese do të radhitej i fundit për pastërti. “Momentalisht dihet si qytetet ashtu edhe fshatrat e Kosovës janë në një gjendje katastrofale për nga ana e pastërtisë. Nëse bëhet një krahasim me vendet e tjera të cilat kanë një mjedis më të mirë dhe më të pastër atëherë mund të thuhet se ne jemi të fundit në atë listë” tha Kelmendi.

Krahas gjithë kësaj pakënaqësie të qytetarëve të Kosovës ndaj mjedisit që i rrethon, roli i Organizatave Joqeveritare Mjedisore shihet si i mangët. Në anën tjetër institucionet arsimore mund të jenë bartës të mëdhenj të sensibilizimit të qytetarëve për mjedisin. Sipas Zeqir Veselajt, drejtor i REC-ut njohuritë nga institucionet arsimore për mjedisin janë të pakta dhe jo të nivelit të duhur në krahasim me sfidat të cilat atakohet mjedisi në Kosovë dhe në rajon. Vetëdijesimi është njëri prej elementeve që mundet ta ndihmojë qytetarin e Kosovës të mos paguajë një kosto tepër të lartë për të. Vonesa e trajtimit serioz të mjedisit është indikator i kryesorë që ndikon në rritjen e kostos së kurimit.

Deklarata e Misionit të ASI-t

Iniciativa për Mbështetje Kuvendit është një mekanizëm koordinues mes agjensioneve të ndryshme për programe demokratizimi në mbështetje të punës së Kuvendit të Kosovës si dhe fuqizimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës. Puna e ASI-t përqëndrohet në kulturën demokratike politike të bazuar në njohjen dhe respektimin e rregullave demokratike të punës, transparencës dhe përgjegjshmërisë ndaj opinionit publik, zhvillimit dhe implementimit të agjendës legjislative, mbikëqyrjes mbi Ekzekutivin, respektin për shumëgjuhësinë dhe pjesëmarrjen në kontakte të ndryshme rajonale dhe ndërparlamentare.

Partnerët e ASI-t punojnë për të bashkuar resurset, shkëmbyer informacionin dhe koordinuar programet duke identifikuar nevoajt në një interaksion të drejtëpërdrejtë me Kuvendin. Si koordinatori i ASI-it Misioni i OSBE-së në Kosovë ndërldihet me gjithë partnerët e ASIT dhe fton në takime të rregullta koordinuese gjithnjë në konsultim dhe përfaqësuesit e Kuvendit. Buletini i rregullt i ASI-t informon publikun vendas dhe ndërkombtarë mbi zhvillimet në Kuvendin e Kosovës dhe programin mbështetës të ASI-t.

Anëtarët të tanishëm të ASI-t:

Friedrich Ebert Stiftung (FES), Friedrich Naumann Stiftung (FNSt.) Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Projekti i Praktikave Parlamentare Lindje-Perëndim (EWPPP), Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) në bashkëpunim me Konzorciumin e parlamenteve të Francës, Gjermanisë, Belgjikës, Sllovenisë dhe Institutin për Mbrojtje të Parisit, Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Nacional Demokratik (NDI), Programi Zhvillimor i KB-ve (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërkombëtar (IPU), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës.



Këshilli redaktues:

Ramë Manaj, Skender Durmishi, Sven Lindholm, Alfons Lentze, Dale Archer, Krenar Loshi, Artan Canhasi and Franklin De Vrieze.

Redaktor: Armend Bekaj

Grafika dhe faqesja: Tomor Rudi

Selia e Misionit të OSBE, 10000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
kontakt: franklin.devrieze@osce.org
<http://www.osce.org/kosovo>

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomsdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Fotografitë e këtij buletini :
OSCE